



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 744 Akti

Nr. 810 Vendimi
Tiranë, më 4.11.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Gerrit Sprenger, në datën 4.11.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati 0 (*underground*), salla B, Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Laureta Ahmeti**, ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, aktualisht ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, subjektin e rivlerësimit, znj. Laureta Ahmeti, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, pasi shqyrtoi në seancën dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Laureta Ahmeti, aktualisht me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm¹, është subjekt rivlerësimi që i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, bazuar në pikën 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Shqipërisë, pasi në kohën e dorëzimit të deklaratës *Vetting* ushtronte detyrën si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e datës 15.6.2021 në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Brunilda Bektashi, Olsi Komici dhe Suela Zhegu. Në datën 21.6.2021 u zgjodh kryesuese e trupit gjykues komisionerja Suela Zhegu dhe relator u zgjodh komisioneri Olsi Komici.
3. Me vendimin e datës 21.6.2021, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Laureta Ahmeti. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mungesa e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues dhe subjekti i rivlerësimit, vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Gerrit Sprenger.
4. Bazuar në nenet 33, 39, 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
5. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për të tria kriteret e vlerësimit.
6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 21.10.2024 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Laureta Ahmeti bazuar në të tria kriteret, si dhe njoftimin e saj për t’u njohur me

¹ Sipas shkresës nr. *** prot., datë 26.7.2021, të KLGJ-së, bashkëlidhur raportit të KLGJ-së.

rezultatet e hetimit, materialet e dosjes, si dhe dokumentet e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 21.10.2024 me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, me të drejtën e saj për të paraqitur brenda datës 30.10.2024 (ora 13:00) pretendime/sqarime shtesë apo për të kërkuar marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

8. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka dërguar pranë Komisionit prapësimet dhe provat në lidhje me rezultatet e hetimit, të cilat janë protokolluar me nr. ***, datë 30.10.2024.

9. Me *email*-in e datës 30.10.2024, Komisioni i njoftoi subjektit ftesën për seancën dëgjimore të datës 4.11.2024 (ora 10:00).

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 4.11.2024 (ora 10:00), në Sallën e Konferencave të Pallatit të Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

11. Në seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe në përfundim kërkoi konfirmimin e saj në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

12. Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur me prova e shpjegime, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 dhe duke respektuar afatet e përcaktuara nga Komisioni.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

13. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, sipas të cilit anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

14. Për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të saj, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshiu tri kritere vlerësimi: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; vlerësimin e aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

15. ILDKPKI-ja ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe në përfundim ka hartuar dhe dërguar pranë Komisionit raportin përkatës² ku, bazuar në pika 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje pasurie;
- ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

16. Komisioni vëren se në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë sipas nenit 31/1³ të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 30.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e ligjit në fuqi⁴. Pas analizimit të kësaj deklarate, raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, si dhe të informacioneve të marra nga subjekte të së drejtës publike, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, në deklaratën *Vetting* sipas formularit (shtojca nr. 2) datë 30.1.2017, janë deklaruar pasuritë si vijon:

❖ Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit

1. Apartament banimi me sip. 125 m², me kontratë jopërfundimtare sipërmarrjeje nr. * rep., nr. *** kol., datë 8.3.2010, e paregjistruar në regjistrat publikë. Vlera 137.500 euro. Pjesa takuese: 30% të subjektit dhe 70% të babait të bashkëjetuesit.**

Burimi i krijimit: *Pjesërisht të ardhurat e mia nga paga ndër vite dhe të familjes së bashkëjetuesit, dhe pjesa më e madhe nga të ardhurat e prindit të bashkëjetuesit, P. H., nga puna si noter.*

1.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.3.2010, e lidhur midis sipërmarrësit shoqëria “****” dhe porositëses Laureta Ahmeti, për porositjen e apartamentit nr. ***, kati 3, me sip. 125 m², rruga “****”, Tiranë, me vlerë 137.500 euro. Në kontratë pagesat janë parashikuar: *Me nënshkrimin e kontratës likuidohet shuma 100.000 euro në prani të noterit; kësti i dytë prej 30.500 euro brenda 5-mujorit nga data e nënshkrimit të kontratës; kësti i tretë prej 7.000 euro në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes*; (ii) aktmarrëveshje datë 15.2.2010 (e lidhur para avokatit midis znj. Laureta Ahmeti dhe shtetasit P. H., babai i bashkëjetuesit të subjektit), për blerjen në bashkëpronësi të apartamentit me sip. 125 m² në rrugën “****”, Tiranë. Në aktmarrëveshje, shtetasi P. H. deklaron se e trajton subjektin e rivlerësimit si bashkëshorten e djalit të tij të vetëm, me të cilët qëndrojnë e banojnë së bashku, dhe për blerjen e apartamentit ai do të kontribuojë sipas mundësive,

² Me shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2018, dërgohet nga ILDKPKI-ja akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Laureta Ahmeti.

³ Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të plotësojë deklaratën e pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

⁴ Referuar parashikimit kushtetues të nenit 84/3, datës së miratimit të ligjit nga Parlamenti, datës të botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare⁴, si dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, ligji hyri në fuqi në datën 8.10.2016. Në datën 25.10.2016, ligji u pezullua nga Gjykata Kushtetuese. Për këtë arsye, afati i zbatimit të ligjit eci për 17 ditë, deri më 19.1.2017. Në datën 18.1.2017, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ligjit. Ky vendim u botua në Fletoren Zyrtare në datën 19.1.2017. Si rezultat, afati 30-ditor në dispozicion të subjekteve të rivlerësimit për dorëzimin ka përfunduar në datën 31.1.2017.

duke dhënë gjithçka ka arritur nga puna e tij dhe kursimet familjare ndër vite në mënyrë të përbashkët me marrëveshjen e të dyja palëve dhe mirëbesim të plotë.

1.2 Sipas nenit 2, paragrafi 5 dhe nenit 4 të kësaj aktmarrëveshjeje, subjektit i është dhënë e drejta për të kryer të gjitha procedurat administrative e ligjore për përgatitjen e dokumentacionit për blerjen e apartamentit, ndërsa kontrata e shitjes do të bëhet dhe regjistrohet në emër të nipit nëse lind djalë, ose në bashkëpronësi të të dyve (subjektit dhe shtetasit P. H.) sipas kontributit të dhënë për blerjen e saj. Çdo procedurë paraprake me shoqërinë ndërtuese, përfshirë edhe kryerjen e pagesave, do të bëhet me miratim paraprak të subjektit dhe shtetasit P. H..

1.3 Rezultoi se referuar çmimit të EKB-së⁵ për vitin 2010, vlera e apartamentit me sip. 114,4 m² është pothuaj 2 herë e lartë se çmimi referencë, prandaj nuk ka dyshime për favorizim të subjektit të rivlerësimit në çmimin e blerjes së apartamentit.

Analiza e mundësisë financiare për blerjen e apartamentit me sip. 125 m² në Tiranë

1.4 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim krijimi: (i) pjesërisht të ardhurat e saj nga paga ndër vite; (ii) pjesërisht të ardhurat e familjes së bashkëjetuesit; (iii) pjesa më e madhe nga të ardhurat nga puna si noter e babait të bashkëjetuesit P. H.. Gjithashtu, ka deklaruar se mbi apartamentin e banimit me sip. 125 m² ajo zotëron 30% të pronësisë, ndërsa vjehri i saj zotëron 70%.

1.5 Referuar nenit 2, paragrafët 2 dhe 3 të aktmarrëveshjes⁶ datë 15.2.2010, palët janë dakordësuar duke lënë të hapur mundësitë e një kontributi të barabartë në blerjen e apartamentit, ose një kontributi jo të barabartë, por sipas mundësisë së secilit, dhe që asnjëherë apartamenti nuk do të ishte në pronësi vetëm të subjektit.

1.6 Në lidhje me këtë, në pyetësin nr. 3, subjektit iu kërkua të saktësojë dhe provojë me dokumentacion ligjor: (i) vlerën që ka paguar nga të ardhurat e saj; (ii) vlerën që ka paguar babai dhe familja e bashkëjetuesit të saj; (iii) vlerën totale të paguar për apartamentin; (iv) kohën e kryerjes së pagesave; (v) pjesën takuese që zotëron secili prej tyre në këtë apartament.

1.7 Në lidhje me vlerën që ka paguar subjekti dhe familjarë të tjerë të bashkëjetuesit, subjekti shpjegoi⁷ se për blerjen e apartamentit fillimisht i ka dorëzuar babait të bashkëjetuesit shumën 2.300.000 lekë, me burim kursimet e saj nga paga dhe pjesa tjetër janë plotësuar nga babai i bashkëjetuesit. Nga ai moment e në vijim pas vitit 2010 i ka dhënë babait të bashkëjetuesit pjesën më të madhe të pagës, duke e shlyer në vazhdimësi, meqenëse kanë jetuar e jetojnë në të njëjtën banesë. (Në këtë kuadër, gjatë hetimit subjekti shpjegoi se shpenzimet e jetesës janë paguar bashkërisht nga ajo dhe bashkëjetuesi, por më shumë nga ai⁸, ndërsa pjesën më të madhe të të ardhurave të saj nga puna dhe qiraja e apartamentit,

⁵ Sipas udhëzimit nr. 3, datë 3.2.2010 "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja, për vitin 2010", çmimi i shitjes së apartamenteve në tregun e lirë për qytetin e Tiranës është 84.750 lekë/m² x 114,4 m² = 9.695.400 lekë. Kjo vlerë e konvertuar në euro (me kursin 139,35 euro) është 69.575 euro.

⁶ Palët kanë marrë përsipër detyrimin që të kontribuojnë në mënyrë të përbashkët e të barabartë për blerjen e këtij apartamentit sipas mundësive. Secila nga palët mund të kontribuojë më shumë në një moment të caktuar sipas mundësive, por ka të gjithë të drejtën ligjore që të kompensohet nga pala tjetër për shpenzimin e bërë më tepër, qoftë duke e paguar menjëherë, qoftë duke e likuiduar në mënyrë periodike e nëpërmjet punës, apo në çdo mënyrë tjetër të ligjshme, ose mund t'i njihet palës tjetër si kontribut më i madh në pjesën e tij takuese, gjithmonë me mirëkuptim e mirëbesim të plotë.

⁷ Përgjigja nr. 2 e pyetësit nr. 3.

⁸ Në pyetësin standard.

subjekti i ka konsumuar së bashku me familjen e saj⁹). Pagesat që subjekti i rivlerësimit i ka dhënë më pas babait të bashkëjetuesit nga paga e saj dhe qiraja, janë marrë prej tij dhe në pjesën më të madhe janë konsumuar për jetesën e përbashkët familjare.

1.8 Në lidhje me pjesët takuese, subjekti shpjegoi¹⁰ se që në momentin e deklaratës *Vetting* palët janë dakordësuar që ajo të deklaronte pjesët 30% në zotërim të saj dhe 70% në zotërim të babait të bashkëjetuesit, pikërisht për shkak të kontributit të saj financiar fillestar dhe atij pas likuidimit të dy kësteve, por edhe për shkak të kontributit njerëzor e familjar që ka dhënë pa ndërprerje në familjen H.. Ka qenë dëshira e shtetasit P. H. që subjekti të ketë pjesën e saj prej 30% të apartamentit, ndërsa ai vetë pjesën e tij prej 70%, të cilën ia kalon djalit të tij A. H., sikurse u provua edhe me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.2.2023, të depozituar nga subjekti, deklaratë e cila do të jetë pjesë e procesit të legalizimit dhe regjistrimit të apartamentit.

1.9 Në lidhje me pagesat e çmimit të apartamentit, subjekti shpjegoi¹¹ se pagesat janë kryer sikurse përcaktohet në kontratën e sipërmarrjes, ndërsa kësti i tretë 7.000 euro është paguar në datën 10.7.2024, me qëllim mospengimin e procesit të legalizimit të objektit që po kryhet nga të gjithë banorët për apartamentet e tyre individuale, kjo për shkak të problematikave të shoqërisë ndërtimore me pronarët e truallit. Detyrimin 7.000 euro dhe kohën e likuidimit të tij subjekti e ka deklaruar edhe në deklaratën *Vetting*.

1.10 Për të provuar këto pagesa, subjekti depozitoi deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.7.2024, ku administratori i shoqërisë “****” sh.p.k. deklaroi se znj. Laureta Ahmeti do të shlyejë në datën e kësaj deklarate këstin e mbetur prej 7.000 euro, duke shlyer kështu të gjithë vlerën e apartamentit, dhe ajo ka të drejtë të vijojë me procedurat e legalizimit të pasurisë pranë ASHK-së përkatëse. Subjekti ka deklaruar në këtë deklaratë se ka shlyer të gjitha detyrimet dhe ka marrë në dorëzim apartamentin.

1.11 Për efekt të analizës financiare, Komisioni konsideroi si datë të pagesës së kështit të parë prej 100.000 euro datën 8.3.2010, kur është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes (sikurse është përcaktuar edhe në këtë kontratë); si datë të pagesës së kështit të dytë prej 30.500 euro konsideroi datën 8.8.2010, pra 5 muaj nga data e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes (sikurse është përcaktuar edhe në këtë kontratë), i cili është i vetmi akt shkresor ku mund të bazohemi për datat e pagesave, pasi kërkesës së Komisionit¹² për të paraqitur dokumentacionin financiar që provon pagesat e çmimit prej 137.500 euro të apartamentit, shoqëria “****” sh.p.k. nuk i është përgjigjur.

1.12 Pra, referuar aktmarrëveshjes datë 15.2.2010, deklaratës noteriale datë 20.2.2023 dhe shpjegimeve të subjektit në pyetësorë, rezultoi se subjekti deri në datën 8.8.2010 ka kontribuar me shumën 2.300.000 lekë, me burim “Kursimet e saj nga paga”, ndërsa pjesa tjetër është plotësuar nga babai i bashkëjetuesit me të ardhurat nga aktiviteti i tij dhe të familjes, të ardhura ku janë përfshirë edhe të ato që subjekti ka sjellë në ekonominë e përbashkët të kësaj familjeje. Palët janë dakordësuar duke përcaktuar pjesët e tyre zotëruese mbi apartamentin, prej 70% bashkëjetuesi dhe 30% subjekti i rivlerësimit, duke e kompensuar pjesën tjetër të saj me pagat e saj dhe pjesën e saj nga qiraja e apartamentit, të cilat i ka dorëzuar pranë familjes së bashkëjetuesit, si dhe nëpërmjet kontributit human si bashkëjetuese në këtë familje. Pagesa

⁹ Në pyetësorin nr. 4.

¹⁰ Përgjigjja nr. 2 dhe përgjigjja shtesë e pyetësorit nr. 3.

¹¹ Përgjigjja nr. 2 e pyetësorit nr. 3 dhe shtesa e pyetësorit nr. 3.

¹² Shkresa nr. *** prot., datë 12.7.2024 dhe email datë 31.7.2024 të Komisionit.

e vlerës 137.500 euro të apartamentit u provua me kontratën e sipërmarrjes datë 8.3.2010 (neni 1, paragrafi 5, vetëm për shumën 100.000 euro) dhe me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.7.2024 (e gjithë vlera 137.500 euro).

1.13 Rezultoi se subjekti nuk ka martesë ligjore me bashkëjetuesin e saj, pavarësisht se jeton në një banesë të përbashkët me të dhe familjen e tij. Në këto kushte, referuar neneve 66, 73, 163 dhe 164 të Kodit të Familjes, kur nuk ka “bashkësi ligjore të martesës” që përcakton barazinë e pjesëve midis bashkëshortëve mbi pasuritë martesore, atëherë rregullimi i regjimit pasuror dhe i marrëdhënieve pasurore bëhet me vullnetin dhe pëlqimin e palëve, sikurse ka ndodhur në rastin e subjektit.

1.14 Për sa më lart, sa i takon pjesës takuese të subjektit dhe pagesës së kryer prej saj, rezultoi se:

i) Sipas akteve shkresore të cituara më sipër, pjesa takuese e subjektit në apartament është 30% ose ekuivalenti në vlerë monetare 5.434.412 lekë¹³.

ii) Në pjesën takuese prej 30% të subjektit përfshihet shuma 2.300.000 lekë, e cila është dhënë tek babai i bashkëjetuesit, si kursim personal i subjektit, deri në datën 8.8.2010. Ky kursim personal e ka zanafillën para fillimit të bashkëjetesës, në datën 1.4.2006. Ndërsa, pjesa tjetër e investimit është dhënë deri në datën 31.12.2016 dhe është e përbërë nga pagat e subjektit, qiraja¹⁴ e apartamentit dhe kontributi human në familje.

1.15 Në përfundim, në lidhje me pagesat e çmimit të apartamentit, u konkudua si vijon:

- Kontributi personal financiar i subjektit të rivlerësimit është shuma 2.300.000 lekë, e cila është paguar brenda datës 8.8.2010. Kjo vlerë është analizuar si shpenzim i subjektit për blerjen e apartamentit.
- Sa i takon diferencës prej 3.134.412 lekësh, e cila do të plotësonte pjesën ideale të ekuivalentit në vlerë të pjesës takuese prej 30%, ajo është konsideruar në analizën financiare si pjesë e kursimeve të përbashkëta të familjes H., në të cilat subjekti ka dhënë kontributin e saj nëpërmjet pagës, pjesës takuese të qirasë dhe kontributit human.

1.16 Për të verifikuar mundësinë e subjektit dhe familjes së bashkëjetuesit për të paguar çmimin e apartamentit, referuar burimeve të krijimit të apartamentit që subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, Komisioni analizoi: (i) të ardhurat e subjektit nga paga ndër vite; (ii) të ardhurat e familjes së bashkëjetuesit; (iii) të ardhurat nga puna si noter e babait të bashkëjetuesit, P. H.. Në këtë analizë, verifikimi i kryer lidhet me pagesën e vlerës 130.500 euro deri në datën 8.8.2010 për të paguar për apartamentin.

1.17 Të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit janë të dokumentuara nga institucione të ndryshme¹⁵ ku ajo ka punuar, që kur ka filluar të gjenerojë të ardhura në qershor të vitit 2001. Pagat e

¹³ Kjo vlerë është përlogaritur si 30% e shumës së paguar deri në datën 8.8.2010, pra 30% e 130.500 euro ose 18.114.705 lekë.

¹⁴ Vlera së qirasë së apartamentit është administruar nga shtetasi P. H., sikurse edhe çdo e ardhur tjetër familjare.

¹⁵ (i) Dokumente bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: vërtetim page nr. ***, janar 2017, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë; vërtetim page nr. ***, datë 27.10.2016, nga Ministria e Financave; vërtetim nr. ***, datë 28.10.2016, nga Agjencia e Trajtimit të Pronave; vërtetim për pagat e viteve 2007 – 2008 nga Bordi Rajonal i Kullimit Durrës; vërtetim page për përuhdhën prill – maj 2007 nga Policia e Ndërtimit Durrës; vërtetim nr. ***, datë 20.1.2017, nga Prefekti i Qarkut Durrës. (ii) Dokumente të administruara nga Komisioni: shkresa nr. *** prot., datë 9.7.2024, e Drejtorisë së Arkivit Qendror të ISSH-së; shkresa nr. *** prot., datë 30.5.2024, e ISSH-së; shkresa nr. *** prot., datë 4.6.2024, e ISSH-së Drejtoria Rajonale Durrës; (iii) Dokumente bashkëlidhur pyetësorit nr. 3: librezë pune e znj. Laureta Ahmeti.

përfituara në këtë periudhë janë në vlerën 2.674.161 lekë, nga të cilat subjekti ka deklaruar se ka kursyer dhe dorëzuar tek babai i bashkëjetuesit të saj vlerën 2.300.000 lekë. Analiza e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit përfshin dy periudha.

1.18 *Periudha qershor 2001 – 1.4.2006*, kur subjekti ka filluar të jetojë me bashkëjetuesin dhe familjen e tij. Në këtë periudhë janë konsideruar të ardhurat e subjektit, shpenzimet e saj vetjake të jetesës dhe likuiditetet e krijuara prej saj gjatë kësaj periudhe, në mënyrë kumulative. Nga analiza financiare e kësaj periudhe, subjekti rezultoi me pamjaftueshmëri burimesh prej 1.860.553 lekësh¹⁶.

1.19 Kjo pamjaftueshmëri vjen për shkak të krijimit të depozitave të subjektit në Bankën e Kursimeve BKT, duke filluar nga prilli i vitit 2005. Rezultoi se këto depozita e kanë origjinën si më poshtë vijon:

- Gjatë vitit 2005, subjekti ka depozituar në këtë bankë shumën 1.280.000 lekë¹⁷ dhe në janar të vitit 2006 ka depozituar shumën 840.000 lekë. Pra, depozitat e krijuara prej saj para bashkëjetesës kanë qenë në shumën 2.120.000 lekë.

- Pas fillimit të bashkëjetesës, në korrik të vitit 2006, këto depozita janë shtuar me 550.000 lekë, duke arritur kështu në shumën 2.670.000 lekë.

- Çdo shumë e depozituar është investuar në depozita me afat 2-vjeçar, fillimisht deri në vitet 2007 dhe 2008, përkatësisht, e në vijim një pjesë e këtyre depozitave është riinvestuar në depozita me afat, ndërsa një pjesë është tërhequr gradualisht, deri kur në datën 24.2.2010 çdo vlerë e investuar është tërhequr *cash* dhe llogaria është bërë me balancë 0 (zero).

1.20 Nisur nga krijimi dhe ecuria e depozitës, si dhe koha e tërheqjes së saj, rezultoi se vlerat e depozituara kanë shërbyer për pagesën e shumës 2.300.000 lekë nga ana e subjektit, në vitin 2010.

1.21 *Periudha 1.4.2006 – 8.8.2010*, kur subjekti është analizuar me familjen e bashkëjetuesit. Sipas kësaj analize, subjekti ka pasur mundësi të kursejë dhe të shtojë depozitat e saj në BKT me shumën 550.000 lekë, për shkak të ekonomisë së përbashkët familjare.

1.22 Për sa më lart, u konkludua se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur pjesërisht fonde të mjaftueshme për të krijuar kursime personale dhe për t'i dhënë babait të bashkëjetuesit të saj vlerën 2.300.000 lekë deri në datën 8.8.2010 për pagesën e apartamentit, për shkak të një balance negative në vlerën -1.860.553 lekë.

1.23 *Në lidhje me të ardhurat e ligjshme të personit fizik "P. H." Noter*, referuar dokumentacionit bashkëlidhur deklaratës *Vetting*¹⁸ dhe dokumentacionit të depozituar gjatë hetimit administrativ¹⁹,

¹⁶ Nga qershori 2001 deri në 1 prill 2006: të ardhura të subjektit nga paga në institucione të ndryshme 787.417 lekë; shpenzime jetese për 1 person 526.768 lekë; pasuri në formën e likuiditeteve të krijuara gjatë periudhës 2.121.202 lekë.

¹⁷ Shuma 1.000.000 lekë në datën 27.4.2005 dhe shuma 280.000 lekë në datën 3.8.2005.

¹⁸ Certifikatë datë 14.2.1993 për regjistrimin në organin tatimor të personit fizik "P. H.", noter, me NIPT ***; deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor të viteve 2007, 2008 dhe 2009 të personit fizik "P. H.", noter; formularët e deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për vitet 2009 dhe 2005; tabelat e llogaritjes së taksës vendore të biznesit të vogël dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2004 dhe 2003; mandatpagesat bankare nga Banka Kombëtare për pagimin e tatimit në llogari të Degës së Tatim Taksave Krujë për vitet 1999, 2000, 2001 dhe 2002; fletënjoftimet e tatimit datë 10.5.1998, 5.3.1998 dhe 12.5.1997 për llogaritjen e tatimit mbi të ardhurat për vitet 1997 – 1998 për personin fizik "P. H." (noter).

¹⁹ Përgjigjja nr. 2 e pyetësorit nr. 3 (detyrimet tatimore): vërtetim datë 5.6.2013 nga DRSSH Durrës për sigurimin e P. H. me NIPT ***; për periudhat 1.1.1997 – 31.3.2005 dhe 1.4.2005 – 31.12.2011; fletënjoftim tatimi datë 12.5.1997 për tatimin mbi të ardhurat e vitit 1997 të tatimpaguesit P. H., noter; mandatarkëtimi (M.A.) datë 17.12.1997, 11.6.1997 dhe 11.9.1997 nga Banka e Kursimeve për pagimin e tatimeve 3-mujore të vitit 1997; fletënjoftim tatimi datë 5.3.1998 për tatimin mbi të ardhurat e vitit 1998 të tatimpaguesit P. H., noter; M.A. datë 2.10.1998, 18.12.1998, 16.4.1998 dhe 23.6.1998 nga Banka e Kursimeve për pagimin e tatimeve 3-mujore të vitit 1998; M.A. datë

verifikohet pagesa e detyrimeve tatimore për disa vite, si dhe deklaratat e kryera pranë organeve tatimore mbi qarkullimin e parashikuar dhe atë të realizuar, për disa vite. Sipas ekstraktit historik të personit fizik “P. H.” nga QKB-ja, ai është regjistruar në datën 28.2.2003 dhe është çregjistruar më 1.11.2013.

1.24 DPT-ja ka konfirmuar²⁰ të dhëna mbi qarkullimin e parashikuar dhe/ose atë të deklaruar për vitet 2003 – 2006 dhe 2010 – 2011, ndërsa Bashkia Fushë-Krujë ka konfirmuar²¹ se personi fizik “P. H.”, me NIPT ***, ka shlyer detyrimet për taksat e tarifave vendore për periudhën 2010 – 2011.

1.25 Në përmbledhje të dokumentacionit të mësipërm për personin fizik “P. H.” noter, rezultoi se ai është regjistruar si person fizik në DRT-në Durrës, dega Krujë, në datën 14.2.1993, sipas certifikatës së regjistrimit në organin tatimor; ka filluar të paguajë detyrimet tatimore në vitin 1997; ka deklaruar qarkullimin/të ardhurat e parashikuara për vitet 2003 – 2009 dhe të ardhurat e realizuara për vitet 2009, 2010 dhe 2011.

1.26 Referuar informacionit të sipërcituar, duke kombinuar të dhënat e marra nga DRT Durrës, Bashkia Fushë-Krujë, si dhe mandatpagesat për pagimin e detyrimeve, janë përlllogaritur qarkullimi dhe/ose fitimi për vitet që mungojnë, të cilat janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën nr. 1.

16.2.1999, 27.7.1999 dhe 20.4.1999 nga Banka e Kursimeve për pagimin e tatimit për vitin 1999; M.A. datë 7.2.2000 nga Banka e Kursimeve për pagimin e tatimit për vitin 2000; M.A. datë 21.2.2001 nga Banka e Kursimeve për pagimin e tatimit për vitin 2001; M.A. datë 20.2.2002 nga Banka e Kursimeve për pagimin e tatimit për vitin 2002; M.A. datë 26.2.2004 nga Banka e Kursimeve për pagimin e tatimit të thjeshtuar dhe taksë vendore për vitin 2003; M.A. datë 8.9.2003 nga Banka e Kursimeve për pagimin e tatimit për vitin 2003; M.A. datë 13.9.2004 nga Banka e Kursimeve për pagimin e tatimit për 6-mujorin e dytë për vitin 2004; M.A. datë 11.3.2005 nga Raiffeisen Bank për pagimin e tatimit të 6-mujorit të parë për vitin 2005. M.A. datë 24.11.2005 dhe 29.3.2006 nga Raiffeisen Bank për pagimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2005; formular deklarimi i pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2005, datë 28.3.2006; deklaratë parashikuese e qarkullimit vjetor për vitin 2007, në vlerën 2.400.000 lekë; deklaratë parashikuese e qarkullimit vjetor për vitin 2008, në vlerën 2.800.000 lekë; deklaratë parashikuese e qarkullimit vjetor për vitin 2009, në vlerën 3.000.000 lekë; mandatpagesë datë 31.3.2010 nga Raiffeisen Bank për pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël.

(Taksat vendore) Njoftim nr. ***, datë 28.12.2010, nga Bashkia Fushë-Krujë, që njofton shtetasin P. H. se ka kaluar në biznesin e vogël me TVSH, me xhiro vjetore 5-8 milionë lekë, nga data 5.5.2010; formular deklarimi i pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2010, datë 22.3.2011; M.A. datë 25.3.2011 nga BKT-ja për pagimin e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për vitin 2011; M.A. datë 28.2.2003 nga Banka Kursimeve për pagimin e taksës vendore për biznesin e vogël; M.A. datë ---- nga Raiffeisen Bank për pagimin e taksës vendore për vitin 2006; M.A. nr. ***, datë 13.4.2007 dhe nr. ***, datë 13.4.2007, nga Bashkia Fushë-Krujë për pagimin e taksave vendore; M.A. nr. ***, datë 21.2.2008; nr. ***, datë 13.4.2007, nga Bashkia Fushë-Krujë, për pagimin e taksave vendore, të 2008; M.A. datë 24.3.2009 nga BKT-ja për pagimin e taksave vendore; vërtetim nr. ***, datë 6.4.2009, nga Bashkia Fushë-Krujë, që konfirmon se shtetasi P. H. ushtron aktivitet në territorin e kësaj bashkie dhe nuk ka detyrime të pashlyera ndaj saj; akt detyrimi për taksat dhe tarifave vendore nr. ***, datë 15.3.2009, nga Bashkia Fushë-Krujë për vitin 2009; M.A. datë 18.2.2010 nga Alpha Bank për pagesën e taksave vendore në llogari të Bashkisë Fushë-Krujë.

²⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 11.6.2024, të DPT-së.

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 3.6.2024, e Bashkisë Krujë, drejtuar Komisionit.

Tabela nr. 1

Vitet	Xhiro e parashikuar sipas ligjit/e dokumentuar me deklarata*	Të ardhura të realizuara të përlogaritura/të dokumentuara me deklarata*	Tatimi për t'u paguar/i paguar	Fitimi i përlogaritur/i dokumentuar**
1,997		425,000	34,000	340,000
1,998	0-2 milionë	2,000,000	55,000	1,600,000
1,999	0-2 milionë	2,000,000	68,000	1,600,000
2,000	0-2 milionë	2,000,000	54,000	1,600,000
2,001	0-2 milionë	2,000,000	64,000	1,600,000
2,002	0-2 milionë	2,000,000	54,000	1,600,000
2,003	1,500,000*	1,900,000*	67,000	1,520,000
2,004	1,800,000*	1,950,000*	58,500	1,560,000
2,005	1,900,000*	2,200,000*	80,000	1,760,000
2,006	2,200,000*	2,000,000	33,000	1,600,000
2,007	2,400,000*	2,000,000	31,500	1,600,000
2,008	2,800,000*	2,000,000		1,600,000
2,009	3,000,000*	3,082,300*	205,204	1,801,250**
2,010		2,342,782*	123,509	1,235,084**
2,011		324,425*	5,917	59,170**
	15,600,000	28,224,507		21,075,504

*Të dhënat me * dhe ** janë ato të dokumentuarat.*

i) Për periudhën 1993 – 1996, nuk ka asnjë të dhënë që mund të provojë të ardhura ose pagesa detyrimesh e, për këtë arsye, pavarësisht se nga dokumentacioni evidentohet që shtetasi P. H. është regjistruar në datën 14.2.1993, nuk mund të konsiderohet asnjë e ardhur e ligjshme për këto vite, për shkak të mungesës së plotë të dokumentacionit financiar.

ii) Sa i takon qarkullimit të realizuar, ai është informuar nga organet tatimore, ose kur mungon është përlogaritur bazuar në të dhënat e disponueshme.

- Për vitin 1997, qarkullimi i realizuar është përlogaritur nisur nga masa e tatimit të paguar, e cila është 8%²².

- Për periudhën 1998 – 2002 ka të dhëna për tatimet e paguara në formë paradhënieje. Bazuar në masën e tatimit të paguar dhe ligjet në fuqi të kohës²³, është konkluduar për secilin vit se qarkullimi i korrespondon një vlere vjetore në fashën 0 – 2.000.000 lekë.

Për të përcaktuar një vlerë konkrete në këtë interval, Komisioni u bazua tek xhiroja e realizuar për vitet 2003 – 2005, për të cilën ka informacion nga DRT Durrës, xhiro e cila justifikon një qarkullim mesatar prej 2.000.000 lekë/vit për vitet 1998 – 2002, kur nuk ka informacion nga organet tatimore.

²² Ligji nr. 7679 datë 3.3.1993 “Për tatimin mbi biznesin e vogël” masa e tatimit e përcaktuar për avokatët është 8% për avokatët (një profesion i së njëjtës kategori ose i ngjashëm me atë të noterit).

²³ Ligji nr. 8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël” dhe ligji nr. 8715, datë 15.12.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8313 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, sipas të cilëve bizneset e vogla paguajnë kuota fikse për qarkullimin nga 0 - 2 milionë/vit; ligji nr. 8978, datë 12.12.2002 “Për taksën vendore për biznesin e vogël”, sipas të cilit bizneset e vogla paguajnë kuotë fikse 4%; ligji nr. 9326, datë 6.12.2004, sipas të cilit bizneset e vogla paguajnë kuotë fikse 3%; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, xhiro 0-2 milionë/vit paguan kuote fikse paguan 25.000 lekë/vit; ligji nr. 9844, datë 17.12.2007, tatimi bëhet 10%, duke filluar nga viti 2008.

- E njëjta fashë qarkullimi i realizuar, për të njëjtat arsye, u konsiderua për vitet 2006, 2007 dhe 2008, ku ka informacion vetëm për qarkullimin e parashikuar, i cili është gjithnjë më i lartë se 2.000.000 lekë/vit.

iii) Sa i takon fitimit të personit fizik, ai është i informuar nga DRT Durrës për vitet 2009, 2010 dhe 2011, ndërsa për vitet e tjera fitimi është përlllogaritur duke aplikuar një normë fitimi mbi qarkullimin e realizuar prej 80%, bazuar në praktikën e përdorur nga Komisioni, por edhe nga Kolegji në raste të ngjashme²⁴.

1.27 Të ardhurat e përlllogaritura që paraqiten në mënyrë të përmbledhur në tabelën nr. 1 më sipër janë të përfshira në analizën financiare të familjes së bashkëjetuesit për çdo periudhë të analizuar të familjes së tij, para dhe pas bashkëjetesës së subjektit të rivlerësimit.

1.28 Në lidhje me të ardhurat e bashkëjetuesit A. H. nga puna si person fizik “Avokat” dhe “Noter”, referuar dokumentacionit bashkëlidhur deklaratës Vetting²⁵ dhe dokumentacionit²⁶ të depozituar gjatë hetimit administrativ, provohet pagimi i detyrimeve tatimore, si dhe deklarimi i qarkullimit për disa vite.

1.29 DPT-ja konfirmon²⁷ të ardhurat dhe fitimin e tatimpaguesit A. H.²⁸ për vitet 2011 – 2016, i cili është krijuar në datën 5.4.2005 si person fizik “Noter”, me NIPT ***; nuk ka detyrime të papaguara dhe për periudhën 4.3.2010 – 22.7.2011 ka qenë me status “pezulluar”. Bashkëlidhur janë dërguar dokumentet provuese²⁹.

1.30 Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës konfirmon³⁰ se personi fizik “A. H.”, i regjistruar si tatimpagues, ka status “aktiv” që nga data 11.9.2006; nuk ka dividend pasi është biznes i vogël; nuk ka detyrime të pashlyera; ka realizuar të ardhura dhe fitim për vitet 2011 – 2016, si dhe ka realizuar të ardhura nga paga si i vetëpunësuar për periudhën 2011 – 2016.

²⁴ Vendimet nr. 746, datë 20.3.2024 (G. Sh.); nr. 175, datë 4.7.2019 (V. S.); nr. 254, datë 4.6.2020 (E. Sh.); nr. 199, datë 11.10.2019 (N. T.); nr. 12, datë 6.7.2020 (P. Gj.), të Kolegjit.

²⁵ Certifikatë regjistrimi datë 5.4.2005 në QKB e personit fizik “A. H.”, me NIPT ***; formular deklarami dhe pagese e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për periudhën tatimore 2011; certifikatë regjistrimi datë 5.4.2005 si biznes i vogël; deklarata parashikuese të qarkullimit vjetor për vitet 2007 dhe 2008; vërtetim datë 13.4.2011 nga Bashkia Fushë-Krujë, që konfirmon se personi fizik “A. H.”, me aktivitet “Avokat”, me NIPT ***, ka paguar taksat vendore për viteve 2004 – 2009.

²⁶ Përgjigjja nr. 2 e pyetësorit nr. 3 (detyrimet tatimore).

vërtetim datë 10.5.2019 nga DRSSH Durrës dhe vërtetim nr.***, datë 13.4.2011, nga Agjencia e ISSH Krujë për sigurimin e A. H. (avokat), me NIPT ***, për periudhën 1.1.2004 – 31.3.2009; urdhërpagesë datë 28.3.2006 nga DPT-ja për tatimin e vitit 2005; mandatpagesë datë 7.4.2005 nga Raiffeisen Bank për pagimin e tatimit për vitin 2005; urdhërpagesat datë 28.3.2006 dhe datë 20.10.2006 nga DPT-ja për tatimet 6-mujore të vitit 2006; formular deklarami i pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2006, datë 28.3.2006; deklaratë parashikuese e qarkullimit vjetor për vitin 2007, në vlerën 1.300.000 lekë; deklaratë parashikuese e qarkullimit vjetor për vitin 2008, në vlerën 1.500.000 lekë.

Taksat vendore: mandatarkëtimet nr. ***, datë 13.4.2007 dhe nr. ***, datë 21.2.2008, nga Bashkia Fushë-Krujë, për pagimin e taksave vendore për vitet 2007 dhe 2008; akt detyrimi për taksat dhe tarifatat vendore nr. ***, datë 15.3.2009, nga Bashkia Fushë-Krujë për vitin 2009; mandatarkëtim datë 24.3.2009 nga BKT-ja për pagimin e taksave vendore për vitin 2009; njoftim vlerësimi tatimor për vitin 2007 nga Bashkia Fushë-Krujë; librezë pune datë 15.4.1989.

²⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 11.6.2024, të DPT-së.

²⁸ Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni dhe verifikimeve të faqes elektronike të QKB-së, ka rezultuar se personi fizik “A. H.” ka ndryshuar objektin e aktivitetit nga avokat në noter, në datën 22.7.2011.

²⁹ Deklarata e realizimit të xhiros së viteve 2004 e 2005; formulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat nga biznesi i vogël e vitit 2006; formulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për periudhën 2011 – 2013; formulari i deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për periudhën 2014 – 2023.

³⁰ Me shkresat nr. *** prot., datë 4.7.2017, nr. *** prot., datë 3.7.2017 dhe nr. *** prot., datë 24.7.2017, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës (dosja Vetting).

1.31 Bashkia Fushë-Krujë konfirmon³¹ se personi fizik “A. H.”, me NIPT ***, ka shlyer detyrimet për taksat e tarifat vendore për periudhat 2007 – 2008 dhe 2010 – 2016.

1.32 QKB-ja konfirmon³² se A. i krijuar si person fizik me vendimin nr. ***, datë 7.10.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, i pajisur me NIPT ***, figuron i regjistruar në datën 7.10.2003, me aktivitet “Avokat”. Në datën 4.3.2010, statusi i tij është “pezulluar” dhe pas datës 22.7.2011 ka status “aktiv”, me aktivitet “Noter”.

1.33 Bazuar në informacionin e administruar nga Komisioni, duke kombinuar të dhënat e marra nga DRT Durrës dhe Bashkia Fushë-Krujë, është përllogaritur fitimi për ato vite që mungon informacioni zyrtar për të, sikurse paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën nr. 2.

Tabela nr. 2

Objekti i aktivitetit	Vitet	Të ardhurat e realizuara/të deklaruara në lek	Fitimi i përllogaritur në lek
Avokat deri më 4.3.2010	2005	400,000	320,000
	2006	500,000	400,000
	2007	1,300,000	1,040,000
	2005	400,000	320,000
	2006	500,000	400,000
	2007	1,300,000	1,040,000
	2008	1,500,000	1,200,000
	2009	1,500,000	1,200,000
	2010	300,000 ³³	240,000
Noter nga data 22.7.2011	2011	1,604,500	1,132,929
	2012	3,014,140	2,021,963
	2013	2,579,689	1,761,199
	2014	3,237,835	2,524,659
	2015	3,035,609	2,350,248
	2016	2,461,419	1,847,836
Total		21,433,192	16,038,834

i) Për vitet 2005 – 2010 ka deklarime të kryera nga personi fizik mbi qarkullimin e parashikuar dhe/ose të realizuar, por nuk ka të dhëna mbi fitimin. Për këto vite, ai është përllogaritur duke aplikuar një normë fitimi prej 80% mbi qarkullimin e parashikuar ose të realizuar që disponohet, bazuar në praktikën e përdorur nga Kolegji për profesionin e avokatit³⁴. Për më tepër, norma e fitimit të këtij personi fizik “Noter” gjatë viteve 2011 deri 2016, e informuar nga DRT Krujë, është 80%.

³¹ Shkresë nr. *** prot., datë 3.6.2024, e Bashkisë Krujë, drejtuar Komisionit. Bashkëlidhur, janë depozituar kopje të deklaratave parashikuese të qarkullimit vjetor për vitet ushtrimore 2007 e 2008, bashkë me mandatarëkëtimet për pagesat e detyrimeve tatimore mbi qarkullimin vjetor. Gjithashtu, me shkresën nr. *** prot., datë 30.6.2017, të Bashkisë Krujë drejtuar ILDKPKI-së (dosja *Vetting*, fq. 306), janë depozituar³¹ kopje të deklaratave parashikuese të qarkullimit vjetor për vitet ushtrimore 2006, 2009 dhe 2010.

³² Me shkresën nr. *** prot., datë 5.7.2017, të QKB-së drejtuar ILDKPKI-së dhe ekstrakti historik bashkëlidhur (dosja *Vetting*).

³³ Qarkullimi i parashikuar për vitin 2010, i deklaruar pranë Bashkisë Fushë-Krujë në datën 26.2.2010, ka qenë 1.800.000 lekë. Por meqenëse personi fizik ka operuar deri në datën 4.3.2010, ky qarkullim është përllogaritur për 2 muaj të vitit, si 1.800.000 lekë: 12 muaj x 2 muaj = 300.000 lekë.

³⁴ Vendim nr. 12, datë 6.7.2020 (P. Gj.) i Kolegjit.

ii) Për vitet 2011 – 2016, DRT Durrës ka të dhëna të plota mbi qarkullimin, shpenzimet, fitimin, tatimin mbi fitimin, e për rrjedhojë fitimi neto del si rezultat i këtyre të dhënave.

1.34 Të ardhurat e personit fizik “A. H.”, sikurse paraqiten në tabelën nr. 2, janë të përfshira në analizën financiare të bashkëjetuesit dhe familjes së tij, sipas periudhave të analizuara.

1.35 Meqenëse subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit edhe të ardhurat e familjes së bashkëjetuesit, dhe kryesisht të ardhurat e babait të tij si noter, Komisioni kreu analizën financiare duke përfshirë të ardhurat e familjes H.³⁵ nga viti 1997, kur subjekti ka paraqitur të dhëna mbi të ardhurat e shtetasit P. H. si noter, deri në datën e pagesës së apartamentit.

1.36 Duke përfshirë të gjitha burimet e deklaruara nga subjekti, Komisioni kreu analizën financiare për blerjen e apartamentit, duke përdorur metodologjinë kumulative. Analiza shtrihet për periudhën 1997 – 3.8.2010 dhe periudhën 1997 – 8.8.2010, kur është paguar secili prej kësteve të apartamentit. Sipas analizës për secilën nga periudhat, rezultuan balanca pozitive³⁶, pra subjekti dhe familja e bashkëjetuesit kanë pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për pagesën e kësteve prej 100.000 euro dhe 30.500 euro në mars dhe në gusht të vitit 2010³⁷.

Në konkluzion të analizës juridiko-financiare të mësipërme, duket se:

1.37 Pavarësisht se nga një analizë e drejtpërdrejtë e burimeve duket se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare të paguajë pjesën e vet të vlerës së apartamentit, rezultoi se familja e bashkëjetuesit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar këtë mangësi të subjektit dhe për të paguar pjesën takuese 70% të shtetasit P. H. në vlerën 114.000 euro, për blerjen e apartamentit. Për më tepër, nga një analizë më gjithëpërfshirëse dhe kumulative, kjo familje do të kishte pasur mundësi – për shkak të të ardhurave të tjera nga puna dhe aktiviteti si persona fizikë të familjarëve – për të paguar vlerën e plotë të apartamentit prej 130.500 euro, pa pasur nevojë për bashkinvestimin e subjektit në vlerën 2.300.000 lekë, ose rreth 16.500 euro, sikurse ka rezultuar nga analiza financiare.

1.38 Për sa më lart:

- **Sipas analizës së burimeve të drejtpërdrejta të deklaruara nga subjekti në deklaratën *Vetting*, duket se blerja e apartamentit objekt shqyrtimi ka mungesë të njërit prej burimeve, për shkak të një balance negative në vlerën -1.860.553 lekë. Kjo vlerë përfaqëson pamundësinë pjesore të subjektit të rivlerësimit për të paguar pjesën e saj personale në investim, në vlerën 2.300.000 lekë.**

³⁵ Në pyetësin nr. 3: subjekti ka paraqitur vetëm dy vërtetime datë 20.6.2024 për përfitim pensioni nga P. H. që nga data 28.12.2012 dhe nga S. H. nga data 18.9.2012.

³⁶ Periudha 1997 – 8.3.2010 rezultoi me një balancë pozitive prej 5.908.728 lekësh, ku: të ardhurat e dokumentuara ishin në vlerën 27.615.444 lekë, shpenzimet 6.414.062 lekë dhe pasuritë e krijuara 15.292.654 lekë.

Periudha 1997 – 8.8.2010 rezultoi me një balancë pozitive prej 2.493.721 lekësh, ku: të ardhurat e dokumentuara ishin në vlerën 28.778.556 lekë, shpenzimet 6.736.637 lekë dhe pasuritë e krijuara 19.548.198 lekë.

³⁷ Në analizën financiare u përfshinë: (i) vlera e apartamentit 100.000 euro, paguar në datën 8.3.2010 dhe 30.500 euro në datën 8.8.2010; (ii) të ardhurat e familjes H. nga viti 1997, si dhe të ardhurat e subjektit pas datës 1.4.2006; (iii) shpenzimet e jetesës të cilat u përlogaritën sipas përbërjes së familjes H. prej 4 personash, deri në datën 1.4.2006, nga ku për vitet 1997 – 1999 ato janë përlogaritur si 33% e të ardhurave, sepse vijnë nga ushtrimi i profesionit të noterit të babait të bashkëjetuesit, të cilat janë të ardhura të larta krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë. Ndërsa nga viti 2000 e në vijim, sipas standardit të ILDKPKI-së dhe INSTAT-it; pas datës 1.4.2006 shtohet subjekti dhe në datën 24.4.2010 shtohet edhe vajza e saj.

- **Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokument financiar për të provuar pagesat e kryera për apartamentin gjatë vitit 2010, përveç kontratës së sipërmarrjes datë 8.3.2010 dhe deklaratës noteriale datë 10.7.2024.**

1.39 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për të dhënë shpjegime dhe për të provuar të kundërtën e konkluzioneve si më lart.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.40 Në lidhje me konstatimin e parë të Komisionit në barrën e provës, subjekti i rivlerësimit në prapësime dha shpjegimet si vijon:

1.41 Subjekti pretendon se në përlllogaritjen e të ardhurave të saj nga puna ndër vite duhet të shtohen disa të ardhura, të cilat mungojnë dhe nuk janë ruajtur nga institucionet ku ajo ka punuar, për shkak se i përkasin një periudhe shumë të largët kohore. Konkretisht, subjekti kërkon:

- Të shtohet shuma 265.980 lekë për periudhën prill 2004 – prill 2005, gjatë së cilës subjekti ka punuar në mënyrë të pandërprerë pranë Agjencisë Kombëtare të Privatizimit (AKP) Durrës, nga data 1.6.2001 deri më 1.4.2005. Subjekti e provon këtë me librezën e saj të punës dhe me pagat e disa muajve të shkëputura gjatë viteve 2004 – 2005, bazuar në informacionin e degës së ISSH-së Durrës. Kjo shumë është pjesë e depozitës prej 1.000.000 lekësh, të depozituar në datën 27.4.2005 në BKT.
- Gjatë punësimit në AKP (qershor 2001 – prill 2005), për shkak të ngarkesës në punë dhe kontributit të saj, subjekti është shpërblyer me 3 paga, në shumën rreth 70.000 lekë, por nuk i ka provuar të ardhurat me dokumente.
- Nga shkurtimi i vendit të punës në prill të vitit 2005, ajo deklaroi të ketë përfituar 3 paga dhe leje vjetore të pakryer, gjithsej 4 paga, në shumën 88.660 lekë, por nuk i ka provuar ato me dokumente.
- Për periudhën 1 prill – 1 gusht 2005 (4 muaj) pretendon se ka marrë pagesë papunësie rreth 40.000 lekë, duke e provuar periudhën e papunësisë me librezën e punës.
- Për periudhën 1.6.2006 – 24.8.2006 (3 muaj) të punësimit të subjektit tek ish-Komiteti Shtetëror i Kthimit e Kompensimit të Pronave Durrës, çka provohet edhe nga librezat e punës, ajo pretendon se ka marrë 2 paga shpërblyer kur është mbyllur institucioni, në vlerën prej 80.000 lekësh, por nuk i ka provuar këto të ardhura me dokumente shkresore.

1.42 Gjithashtu, në lidhje me depozitim të shumës 840.000 lekë në janar të vitit 2006, subjekti pretendon se ato janë pjesë e dhuratës prej 1.000.000 lekësh nga familja e bashkëjetuesit për djalin e tyre, me rastin e fejesës. Subjekti dhe bashkëjetuesi, pasi shpenzuan një pjesë të saj, shumën e mbetur vendosën ta depozitojnë në llogarinë bankare të subjektit, pasi bashkëjetuesi nuk kishte llogari bankare në atë kohë dhe as nuk dëshironte të hapte për shkak të një ekspozimi të mundshëm në lidhje me ushtrimin e profesionit të tij³⁸. Kjo shumë, që në momentin e depozitimit, u destinua për tërheqje nga çifti i bashkëjetuesve në vijim, për të mbuluar shpenzimet e tyre të përbashkëta, sikurse edhe ka ndodhur. Subjekti parashtron se kjo shumë nuk ka qenë asnjëherë pasuri e saj dhe se nuk ka qenë pjesë e kursimeve të krijuara që ajo ka dhënë për blerjen e apartamentit në gusht të vitit 2010. Subjekti nuk e kishte deklaruar këtë veprim më parë për shkak të mosdetyrimit ligjor dhe se nuk është pyetur. Ajo ka

³⁸ Për më shumë hollësi, shihni trajtimin në çështjen 1.2 të prapësimeve të subjektit.

paraqitur në cilësinë e provës një deklaratë dore datë 28.10.2024 të familjarëve të bashkëjetuesit dhe deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.10.2024, nga bashkëjetuesi i saj.

1.43 Subjekti i rivlerësimit qartëson se po të shtohen pagat e pretenduara prej saj edhe interesat bankarë, të ardhurat e saj totale arrijnë në vlerën 3.426.704 lekë³⁹, duke mbuluar kështu shumën 2.300.000 lekë, të paguar për apartamentin.

1.44 Në kundërshtim të barrës së provës, subjekti kërkoi: (a) përfshirjen e të ardhurave shtesë, sikurse provuar dhe deklaruar prej saj; (b) konsiderimin e shumës 840.000 lekë (si pjesë e mbetur e dhuratës për fejesë prej 1,000,000 lekësh) si të dhuruar dhe depozituar në janar të vitit 2006; (c) në vijim, konsiderimin e së njëjtës shumë si të shpenzuar dhe jo si pjesë të vlerës 2.300.000 lekë, të paguar për apartamentin. Sipas përlllogaritjeve të subjektit, pamundësia e saj për të krijuar shumën 2.300.000 është rreth -475.000 lekë.

1.45 Në seancën dëgjimore, subjekti ka parashtruar edhe pretendimin se shuma 137.500 euro, që Komisioni e ka konvertuar në vlerën 18,1 milionë lekë, sikurse ka mësuar nga familjarët e bashkëjetuesit, nuk është konvertuar në vitin 2010 kur u paguan dy kështet, por në vitet 2002, 2004 dhe 2005 kur vlera e euros ka qenë 122, 120, apo 128 lekë, dhe kjo shumë është rreth 20% më e ulët sesa vlera e përcaktuar nga Komisioni për vitin 2010.

1.46 Në lidhje me konkluzionin e dytë të Komisionit në barrën e provës, subjekti i rivlerësimit në prapësime shpjegoi se ai është i saktë, duke iu referuar atyre dokumenteve që janë administruar deri në atë moment. Subjekti i ka dhënë babait të bashkëjetuesit vetëm vlerën 2.300.000 lekë, por, ashtu sikur ka konkluduar Komisioni, kjo vlerë mbulohet nga të ardhurat kumulative të familjes.

1.47 Subjekti theksoi se i qëndron shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ se pagesat e apartamentit janë bërë sipas afateve të përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes së datës 8.3.2010 dhe në datën 10.7.2024 është paguar detyrimi i mbetur në shumën 7.000 euro, me qëllim që të vijonin procedurat e legalizimit⁴⁰.

1.48 Ndërtuesi ka kërkuar të kryheshin pagesa *cash* dhe nuk ka lëshuar fatura tatimore shitjeje (por që nuk disponojnë për shkak të periudhës së gjatë që ka kaluar, si dhe nuk kanë mundur të marrin dokumentacion nga ndërtuesi, sepse marrëdhëniet e tyre kanë qenë problematike).

1.49 Për kohën kur janë bërë pagesat, lejoheshin pagesat *cash*, prandaj subjekti pretendon se është përmbushur detyrimi përballë shoqërisë ndërtuese.

1.50 Sa më lart, subjekti i rivlerësimit konkludon se vërtetohet kryerja e pagesave të kësteve të vlerës së plotë të apartamentit.

Vlerësimi i Komisionit

1.51 Pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit dhe provat e paraqitura, Komisioni vlerëson të konsiderojë disa nga pretendimet e subjektit, si vijon:

³⁹ Të ardhurat nga puna e saj për periudhën 2001 – gusht 2010 arrijnë në vlerën 2.996.010 lekë plus interesa bankarë në vlerën 430.694 lekë.

⁴⁰ Subjekti sjell në vëmendje deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.7.2024, të nënshkruar nga subjekti dhe ndërtuesi, ku përcaktohet se janë përmbushur edhe detyrimet e fundit në vlerën 7.000 euro.

- Të përfshijë në analizën financiare të ardhurat e përfituara për disa muaj gjatë viteve 2004 dhe 2005, periudhë në të cilën subjekti ka qenë e punësuar pranë Agjencisë Kombëtare të Privatizimit Durrës, bazuar në: (i) librezën e punës, e cila tregon punësim të pandërprerë deri në datën 1.4.2005; (ii) informacionin e përcjellë nga Ministria e Financave për pagat e muajve janar – prill 2004⁴¹; (iii) informacionin e përcjellë nga ISSH Drejtoria e Arkivit Qendror për pagat e muajve shtator, tetor, dhjetor 2004 dhe shkurt 2005⁴². Duke kombinuar të dhënat e dokumenteve të mësipërme, u kryen përllogaritjet nga ana e Komisionit, duke konsideruar pagë për ato muaj që mungojnë, të barabartë me muajin paraardhës ose pasardhës, për të cilin ka informacion të dokumentuar.
- Të ardhurat e papunësisë të përfituara për periudhën 4-mujore, 1.4.2005 – 1.8.2005, u përllogaritën bazuar në librezën e punës së subjektit dhe ligjet e kohës⁴³, sipas të cilëve pagesa e papunësisë është sa 50% e pagës minimale, e barabartë për të gjithë ata që përfitojnë statusin e të papunit.
- Të mos konsiderojë të ardhurat e pretenduara nga subjekti për shpërblimet, lejen vjetore të pakryer, si dhe dëmshpërblimin për 3 muaj pas mbylljes së AKP-së në vitin 2005, pasi këto të ardhura mbeten në nivel deklarativ dhe të padokumentuara, qoftë sa i përket faktit që janë përfituar, ashtu edhe vlerës së tyre. Për më tepër, pretendimet për këto paga subjekti i ka paraqitur vetëm pasi është njohur me rezultatet e hetimit, ndërkohë që ajo ka pasur kohë mëse të mjaftueshme për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm mbi përfitimin e këtyre të ardhurave, ose të paktën ka pasur kohën e nevojshme qoftë edhe t'i drejtohet institucioneve përgjegjëse me kërkesë zyrtare për të marrë informacion, veprim të cilin gjithashtu nuk e ka provuar.

1.52 Në lidhje me pretendimin e subjektit se shuma 840.000 lekë, e depozituar në bankë në janar të vitit 2006, nuk vjen nga të ardhurat e saj, por nga dhurata e dhënë nga familja e bashkëjetuesit, Komisioni e vlerëson si një pretendim bindës, bazuar në disa fakte dhe argumente logjike si: (i) subjekti nuk kishte detyrim ta deklaronte veprimin e depozitimit, pasi ajo nuk ishte subjekt deklarues; gjithashtu as në deklaratën *Vetting*, pasi kjo ishte një dhuratë e marrë para fillimit të bashkëjetesës dhe para fillimit të detyrës; (ii) kjo ngjarje i takon një periudhe shumë të hershme kur subjekti jo vetëm që nuk ka qenë subjekt deklarues, por nuk ka mbajtur asnjë post drejtues në institucionet ku ka punuar, fakte të cilat lidhen jo vetëm me mosdetyrimin e saj për të deklaruar, por edhe me një tendencë natyrale për të sjellë në vëmendje situatat ashtu siç kanë ndodhur; (iii) bashkëjetesa e saj ka filluar në prill të vitit 2006, ndërsa depozitimi në janar të vitit 2006, kohë të cilat përputhen me deklarinimin se dhurata është bërë me rastin e fejesës së subjektit në kohën e festave të fundvitit 2005; (iv) dhuratën prej 1.000.000 lekësh e kanë pohuar edhe prindërit e bashkëshortit, të cilët kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për t'ia dhuruar këtë shumë djalit të tyre; (v) duket bindëse arsyeja e depozitimit të shumës 840.000 lekë në llogarinë e

⁴¹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2016, nga Ministria e Financave, e cila informon se subjekti ka pasur pagë mujore në vlerën 18.276 lekë, për periudhën janar – prill 2004. Paga e 4 muajve pasardhës maj – gusht 2004, e cila mungon, është konsideruar e barabartë me atë të periudhës janar – prill.

⁴² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 8.7.2024, nga ISSH Drejtoria e Arkivit Qendror, e cila informon se paga e muajit shtator 2004 është në vlerën 21.686 lekë, e tetorit është 21.839, muaji nëntor mungon dhe prandaj është barazuar me muajin paraardhës, ndërsa muaji dhjetor është informuar në shumën 24.121 lekë. Për vitin 2005, kjo shkresë informon vetëm pagën e muajit shkurt, në vlerën 22.165 lekë, e cila është konsideruar e përfituar edhe për 2 muajt e tjerë që mungojnë, pra janar dhe mars 2005.

⁴³ Për përllogaritjen e masës së papunësisë, Komisioni u bazua në: (i) Ligjin për Sigurimet Shoqërore i vitit 1993, i cili ka përcaktuar që masa e pagesës së papunësisë do të përcaktohet çdo vit me Vendim të Këshillit të Ministrave. VKM-ja e parë, e cila përcakton këtë pagesë, daton në vitin 2005, por në të nuk është përcaktuar kjo masë. Ajo është përcaktuar për herë të parë vetëm në VKM-në nr. 223, datë 19.4.2006, në nivelin 50% të pagës minimale, prandaj përllogaritja u bë bazuar në këtë të dhënë zyrtare; (ii) VKM-në nr. 460, datë 23.6.2005 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, që përcakton se paga mujore bazë minimale në shkallë vendi është 11.800 lekë.

subjektit dhe jo në atë të bashkëjetuesit, pasi ka rezultuar se bashkëjetuesi nuk ka pasur llogari bankare deri në mars të vitit 2009⁴⁴. Bashkëjetuesi ka deklaruar në deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.7.2024, se ka qenë ai që ka kërkuar nga subjekti këtë depozitim.

1.53 Pretendimet e subjektit se në fakt vlera prej 130.500 euro e paguar për apartamentin deri në gusht të vitit 2010 nuk është këmbyer në momentin/vitin e pagesës, por gradualisht gjatë viteve 2002, 2004 e 2005, nuk u morën në konsideratë, pasi ato mbeten në nivel deklarativ.

1.54 Sa më sipër, Komisioni ka konsideruar dhe ka reflektuar në analizën financiare:

- i) shtimin e të ardhurave të subjektit në vlerën 252.684 lekë, vetëm për ato periudha të cilat janë provuar me dokumentacion;
- ii) vlerën 1.000.000 lekë, që është konsideruar si dhuratë nga ana e familjes së bashkëjetuesit dhe është pasqyruar si shpenzim në analizën e familjes së tij nga viti 1997 deri në datën 1.4.2006;
- iii) vlerën 840.000 lekë, që është konsideruar si e ardhur e dhuruar e subjektit në janar të vitit 2006, pra përpara bashkëjetesës; ajo përbën një të ardhur të ligjshme, pasi familja e bashkëjetuesit ka pasur burime financiare të mjaftueshme për krijimin e saj;
- iv) e njëjta vlerë është konsideruar si shpenzim familjar në vitin 2008, pavarësisht se në parashtrimet e saj subjekti nuk e ka specifikuar kohën e shpenzimit të tyre. Ky konsiderim bazohet në faktin që në analizën kumulative koha/viti në të cilin janë shpenzuar këto para nuk e afekton analizën; gjithashtu bazuar në lëvizjet e llogarisë së subjektit, ku janë evidentuar tërheqje në shuma të përafërta me shumën 840.000 lekë në vitet 2008 dhe 2009⁴⁵.

1.55 Në përfundim, pas rikryerjes së analizës financiare të subjektit për periudhën qershor 2001 deri në datën e bashkëjetesës, 1.4.2006, rezultoi një mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën - 767.869 lekë⁴⁶.

1.56 Por, edhe në rast se në analizën financiare përfundimtare nuk do të ishte konsideruar dhurata e prindërve të bashkëjetuesit në vlerën 840.000 lekë, analiza financiare e subjektit para bashkëjetesës do të kishte rezultuar me një pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme prej -1.607.869 lekësh, e cila nuk mund të përbënte shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit për arsye të vlerës së kësaj balance, periudhës së analizuar, por edhe për shkak të tërësisë së fakteve, rrethanave dhe sjelljes së subjektit, të cilat të krijojnë bindjen se deklaratimet e saj përputhen me realitetin. Kjo edhe në respektim të parimit të proporcionalitetit.

1.57 Sa i takon analizës në momentin e blerjes së apartamentit, Komisioni e ka rishikuar atë, nën dritën e konsiderimeve të provave dhe rrethanave të shpjeguara nga subjekti në parashtrimet e saj dhe të konsideruara nga Komisioni. Analiza financiare për periudhat 1997 – 8.3.2010 dhe 1997 – 8.8.2010 ndryshon, por rezultati i saj mbetet pozitive dhe, për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit për mundësinë

⁴⁴ Nga shqyrtimi i informacionit të përcjellë nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, ka rezultuar se bashkëshorti ka çelur llogari page për herë të parë në Raiffeisen Bank në mars të vitit 2009, të cilën e ka mbajtur me shuma minimale deri në gusht 2011, kur është kredituar paga e tij e fundit. Gjithashtu, shtetasit A. dhe P. H. kanë hapur llogari dhe kanë depozituar në total shumën 8.100.000 lekë vetëm në datën 26.1.2017, disa ditë përpara plotësimit dhe dorëzimit të deklaratës *Vetting* nga subjekti.

⁴⁵ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 6.6.2024, të BKT-së, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴⁶ Të ardhura në vlerën 1.880.101 lekë, nga të cilat të ardhurat nga paga 1.040.101 lekë dhe dhuratë nga prindërit e bashkëjetuesit 840.000 lekë; shpenzime jetese për një person për periudhën 526.768 lekë; pasuri që përbëhen nga likuiditetet në banka, në vlerën 2.121.202 lekë.

e subjektit dhe familjes së bashkëjetuesit për të paguar vlerën 130.500 euro mbetet i njëjtë me atë të rezultateve të hetimit.

Tabela nr. 3

	1997 – 8.3.2010	1997 – 8.8.2010
PASURI	15,292,654	19,548,198
Apartament + truall me sip. 1478 m ² , Fushë-Krujë, bashkëjetuesi 100% blerë më 4.12.2001	500,000	500,000
Apartament banimi me sip. 125 m ² , kontratë sip. datë 8.3.2010, pjesa takuese 30%	13,881,000	18,114,705
Mercedes-Benz me targë ***, blerë më 4.10.2006, bashkëjetuesi 100%	600,000	600,000
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve⁴⁷</i>	<i>311,654</i>	<i>333,493</i>
TË ARDHURA dokumentuar	28,968,776	30,131,889
Të ardhura të subjektit nga paga në institucione të ndryshme	1,596,305	1,886,744
Të ardhura të bashkëjetuesit nga paga	154,833	412,888
Të ardhura të bashkëjetuesit si profesion i lirë (avokat dhe noter)	4,204,000	4,304,000
Të ardhura të babait të bashkëjetuesit si noter	20,007,682	20,522,300
Të ardhura të motrës së bashkëjetuesit	1,221,930	1,221,930
Të ardhura nga interesat bankarë (subjekti)	430,694	430,694
Mbartja e depozitave bankare të subjektit (sistemim veprimi)	1,353,333	1,353,333
SHPENZIME	8,258,362	8,580,937
Shpenzime jetese për 5 persona	6,291,146	6,613,721
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit TIMS	121,416	121,416
Paguar në Hipotekë	1,500	1,500
Shpenzime të tjera të evidentuara	4,300	4,300
Shpenzuar vlera e dhuratës nga çifti mbi shpenzimet e jetesës	1,840,000	1,840,000
Mundësia për kursime kumulative	5,417,760	2,002,754

1.58 Në lidhje me qëndrimin e subjektit ndaj konkluzionit të Komisionit se *subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokument financiar për të provuar pagesat e kryera për apartamentin gjatë vitit 2010, përveç kontratës së sipërmarrjes datë 8.3.2010 dhe deklaratës noteriale datë 10.7.2024*, Komisioni vlerësoi se shpjegimet e subjektit konsiderohen të mjaftueshme dhe bindëse, duke mbajtur në konsideratë tërësinë e fakteve dhe rrethanave në harmoni me njëra-tjetrën dhe mund të vlerësojë se ato janë të mjaftueshme (sidomos dy aktet zyrtare me fuqi ligjore: kontrata e sipërmarrjes dhe deklarata noteriale) për të provuar kryerjen e pagesave të çmimit të apartamentit.

2. Të ardhura të realizuara nga kontrata e qirasë së apartamentit në datën 1.4.2010 si magazinë, për periudhën 1.4.2010 – 1.4.2016, me çmim 350 euro/muaj. Shuma e të ardhurave 23.200 euro.

⁴⁷ Në këtë analizë të fragmentuar, tek gjendja e likuiditeteve nuk është më depozita prej 2.671.202 lekësh e subjektit, e krijuar deri në fund të vitit 2006, pasi ajo është tërhequr gradualisht në vitet 2008 e 2009 dhe është mbyllur më 24.2.2010, ose 2 javë përpara se të paguhej kësti i parë i apartamentit. Sidoqoftë, mbartja e këtyre likuiditeteve afekton analizën e viteve të mëparshme e, për rrjedhojë, edhe të analizës për muajt mars dhe gusht 2010.

2.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* kontratën e qirasë datë 1.4.2010 (jonoteriale⁴⁸) të nënshkruar nga qiradhënësi Laureta Ahmeti dhe qiramarrësi Y. L. për dhënien me qira të apartamentit me sip. 125 m², kati 3, rruga “***”, pallati 10, Tiranë, për një afat 6-vjeçar (1.4.2010 – 1.4.2016) kundrejt vlerës 350 euro/muaj, me destinacion magazinë ose zyrë, por jo për banim.

2.2 Referuar informacionit nga DRT Tiranë⁴⁹, në zbatim të ligjit 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 33 pika “ë”, për tatimin në burim (tatim mbi qira), deri në datën 31.12.2014 nuk ka asnjë dokument (kontratë qiraje) apo shkresë zyrtare në lidhje me pagesat e kryera apo shlyerje detyrimi nga ana e znj. Laureta Ahmeti dhe z. A. H., si individ në rolin e qiradhënësit, apo të shtetasve të tjerë në rolin e qiramarrësit, përfshirë edhe shtetasin Y. L..

2.3 Nga ekstrakti i QKB-së datë 11.7.2024, rezultoi se shtetasi Y. L. figuron i regjistruar si person fizik që në datën 6.8.2001. Në zbatim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 33 pika “ë”, ky person fizik kishte detyrimin të paguante tatimin mbi të ardhurat nga qiraja në rolin e agjentit tatimor.

2.4 Subjekti shpjegoi gjatë hetimit administrativ⁵⁰ se nuk disponon dokumentacion ligjor për përfitimin e shumës 23.200 euro gjatë periudhës 6-vjeçare (1.4.2010 – 1.4.2016), sepse pagesat janë bërë *cash* dhe nuk disponon as të dhëna për detyrimet tatimore mbi këtë shumë, pasi as qiramarrësi nuk e ka likuiduar tatimin mbi të ardhurat nga qiraja.

2.5 Për sa më lart, duket se: (i) kontrata e nënshkruar midis subjektit të rivlerësimit dhe personit fizik “Y. L.” nuk është regjistruar në organet tatimore; (ii) kjo marrëdhënie joformale nuk ka gjeneruar asnjë detyrim për pagesë tatimi e kështu asnjë nga palët nuk e ka paguar tatimit në burim; (iii) të ardhurat e deklaruara nga qiratë nuk kanë kaluar nëpërmjet sistemit bankar, çka do të provonte të paktën përfitimin e të ardhurave nga qiraja.

2.6 Për këto arsye, të ardhurat nga qiraja në vlerën 23.200 euro, për periudhën 1.4.2010 – 1.4.2016, të deklaruara dhe të pretenduara nga subjekti, nuk mund të konsiderohen si të ardhura të përfituara, e për më tepër si të ligjshme në kuptim të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Shqipërisë, prandaj, si të tilla, ato nuk u përfshinë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të familjes së bashkëjetuesit të saj. Mospërfshirja e vlerës 23.200 euro në analizën financiare nuk passjell efekt negativ në këtë analizë të subjektit dhe të familjes së bashkëjetuesit të saj.

2.7 Komisioni i kërkoi⁵¹ shpjegime subjektit, përse kontrata e qirasë datë 1.4.2010 për apartamentin është lidhur vetëm prej saj dhe të ardhurat nga qiraja e apartamentit janë përfituar vetëm prej saj, ndërkohë që në aktmarrëveshjen datë 15.2.2010 ajo dhe babai i bashkëjetuesit janë dakordësuar për gëzimin e apartamentit në mënyrë të barabartë.

2.8 Subjekti shpjegoi⁵² se kontrata e qirasë së apartamentit është nënshkruar prej saj meqë edhe kontrata e sipërmarrjes ishte në emrin e saj. Të ardhurat nga qiraja janë administruar prej saj si veprim procedural,

⁴⁸ Neni 803, paragrafi 4 i Kodit Civil, përcakton se kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit duhet bërë me shkresë (nuk parashikon detyrimisht “me akt noterial”).

⁴⁹ Me shkresat nr. *** prot., datë 24.7.2017 dhe nr. *** prot., datë 27.9.2017, të DRT-së Tiranë, drejtuar ILDKPKI-së (dosja *Vetting*, fq. 317-320).

⁵⁰ Në përgjigjen nr. 3 të pyetësorit nr. 3 dhe përgjigjen nr. 2 të pyetësorit nr. 4.

⁵¹ Pyetja nr. 2 e pyetësorit nr. 4.

⁵² Përgjigjja nr. 3 e pyetësorit nr. 3 dhe përgjigjja nr. 2 e pyetësorit nr. 4.

por nuk janë përfituar vetëm prej saj. Pjesën më të madhe të të ardhurave nga qiraja e ka marrë babai i bashkëjetuesit, si kontribuuesi kryesor në këtë pasuri, dhe subjekti i ka konsumuar së bashku me familjen e bashkëjetuesit ku jeton. Çdo veprim në lidhje me administrimin e apartamentit dhe gëzimin e tij është bërë me dijeninë dhe pëlqimin e babait të bashkëjetuesit, sikurse janë dakordësuar edhe në aktmarrëveshjen datë 15.2.2010.

2.9 Sa i takon pjesës takuese të subjektit për 30% e të ardhurave nga qiratë, si një burim i deklaruar prej saj se është dhënë/dorëzuar tek babai i bashkëjetuesit për t'u menaxhuar dhe, si i tillë, ka shërbyer edhe në pagesën e apartamentit, sikurse analizuar më lart në çështjet 1.17 dhe 1.18, duket se në ekonominë e përbashkët familjare të ardhurat nga qiraja, së bashku me të ardhurat e tjera, kanë shërbyer për të mbuluar çdo shpenzim dhe për të krijuar kursimet familjare. Pra, moskonsiderimi i të ardhurave nga qiratë në analizën financiare për blerjen e apartamentit, trajtuar në çështjen 1 të këtij vendimi, nuk përjashton përdorimin e burimeve të tjera financiare nga ana e subjektit dhe familjes së bashkëjetuesit, të cilët pas datës së fillimit të bashkëjetesës, 1.4.2006, rezultojnë të kenë fonde të mjaftueshme për krijimin e pasurive të tyre.

2.10 Për sa më lart, duket se subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion shkresor përfitimin e vlerës 23.200 euro nga qiraja e apartamentit, si dhe pagesën e tatimit mbi këto të ardhura.

2.11 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konkluzionit si më lart.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

2.12 Në prapësime, subjekti shpjegoi se i qëndron shpjegimeve që ka dhënë gjatë hetimit administrativ se nuk disponon dokumentacion ligjor për përfitimin e shumës 23.200 euro nga qiraja, pasi ato janë marrë *cash*. Subjekti shpjegoi se me qiramarrësin ishin në një marrëdhënie besimi dhe mendonin se ishin paguar detyrimet sipas ligjit, pasi kështu u ishte deklaruar nga qiramarrësi.

2.13 Shuma e përfituar nga qiraja nuk është përmendur, deklaruar e as llogaritur në asnjë rast si pjesë e të ardhurave të subjektit dhe familjes së bashkëjetuesit të saj dhe nuk ka shërbyer si burim kryesor për blerjen e ndonjë pasurie. Kjo shumë është deklaruar në deklaratën *Vetting* vetëm për efekt të ligjit, për vërtetësi apo saktësi. Kjo shumë në tërësi apo në veçanti të mos merret as të pasqyrohet në asnjë rast si e ardhur apo fitim i pretenduar nga subjekti dhe familja e bashkëjetuesit të saj.

2.14 Për këto arsye, duke qenë se subjekti dhe familja e bashkëjetuesit të saj nuk kanë dashur të fshehin asgjë nga marrëdhënia e qirasë, subjekti nuk është dakord me konkluzionin e ILDKPKI-së, që i konsideron: *Deklarim të rremë të ardhurat e deklaruara, të përfituara nga qiraja në shumën 23.200 euro*.

Vlerësimi i Komisionit

2.15 Pasi mori në konsideratë shpjegimet e subjektit të paraqitura në prapësime, Komisioni arrin në përfundimin se konkluzioni i tij do të qëndrojë, por duke vlerësuar korrektesën e shpjegimeve reale dhe pa tendencë fshehjeje të ndonjë rrethane nga ana e subjektit, si dhe pranimin e saj që shumën 23.200 euro të mos merret në konsideratë e të mos përfshihet si e ardhur në analizën financiare, çmon që ky konkluzion të mos ndikojë në vlerësimin e përgjithshëm përfundimtar të subjektit të rivlerësimit.

3. Depozitë me afat 1-vjeçar në BKT. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga dhe interesat vjetorë bankarë në vite. Kjo shumë është depozituar të përdoret për likuidimin total të kontratës së sipërmarrjes dhe regjistrimin e saj sipas ligjit. Vlera 1.330.153 lekë. Pjesa takuese: 100%.

3.1 Referuar informacionit nga Banka Kombëtare Tregtare⁵³, znj. Laureta Ahmeti ka depozitë bankare në vlerën 1.330.153 lekë, e cila e ka zanafillën që në vitin 2012 kur është çelur. Përgjatë viteve në vijim janë kryer disa depozitime në shuma të ndryshme⁵⁴, të cilat janë investuar dhe riinvestuar në depozita me afat 1-vjeçar; principali i tyre është shtuar me interesat e përfituar dhe në datën 30.1.2017 vlera e depozitës ka arritur në 1.330.154 lekë.

3.2 Sa i takon mundësisë së subjektit për të krijuar këto kursime, nga analiza financiare për vitet 2012 – 2015, periudhë kur depozita në vlerën 1.330.153 lekë është krijuar, duket se subjekti ka pasur mundësi që nga paga e saj të krijojë kursime në vlera që i mbulojnë mjaftueshëm këto depozita. Kjo mundësi kursimi është krijuar për shkak të ekonomisë së përbashkët me bashkëjetuesin dhe familjen e tij, të cilët mbulojnë çdo shpenzim të saj.

3.3 Për sa më lart, deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i saktë dhe përputhet me informacionin e përcjellë nga BKT-ja.

Pasuri të deklaruar në deklaratën Vetting nga shtetasi A. H., bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit

4. Apartament banimi, pasuria nr. * në Fushë-Krujë, kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.12.2001, 147 m² truall dhe 51 m² ndërtesë, e blerë nga gjyshja e gjyshi. Burimi i krijimit: të ardhurat nga puna dhe kursimet. Vlera 500.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.**

4.1 Rezultoi se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e administruar⁵⁵.

4.2 Nisur nga fakti që kjo pasuri është krijuar para fillimit të detyrës së subjektit dhe para fillimit të bashkëjetesës së saj më bashkëjetuesin, kjo pasuri nuk mund të jetë objekt hetimi, prandaj Komisioni vlerësoi të mos hetojë dhe analizojë mundësinë financiare për krijimin e saj.

5. Apartament i privatizuar nga Enti Kombëtar i Banesave, në bashkëpronësi me anëtarët e familjes madhore, pasuria nr. *⁵⁶, në Fushë-Krujë, me kontratë privatizimi nr. ***, regjistruar në ZVRPP Krujë me nr. *** regjistri. Pasuria e rivlerësuar sipas ligjit në vitin 2011. Privatizim familja. Pjesa takuese ¼.**

5.1 Rezultoi se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e administruar⁵⁷.

5.2 Nisur nga fakti që kjo pasuri është krijuar para fillimit të detyrës së subjektit dhe para fillimit të bashkëjetesës së saj më bashkëjetuesin, kjo pasuri nuk mund të jetë objekt hetimi, prandaj Komisioni vlerësoi të mos hetojë dhe analizojë mundësinë financiare për krijimin e saj.

⁵³ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2017, të BKT-së, drejtuar ILDKPKI-së (dosja Vetting, fq. 105).

⁵⁴ Data e depozitimit në vlerat e depozituara/gjendja e llogarisë: në datën 6.6.2012, shuma 600.000 lekë; në datën 7.6.2013, shuma 138.276 lekë; në datën 9.6.2014, shuma 244.000 lekë; në datën 15.6.2015, shuma 1.307.886 lekë; gjendja e depozitës në datën 15.6.2015 është 1.307.886 lekë dhe në datën 30.1.2017 është 1.330.154 lekë.

⁵⁵ Për më tepër referojuni dokumenteve të administruara në dosjen e ILDKPKI-së dhe atë të Komisionit.

⁵⁶ Numri i pasurisë është lapsus nga subjekti, sepse në dokumentacion figuron me nr. ***.

⁵⁷ Për më tepër referojuni dokumenteve të administruara në dosjen e ILDKPKI-së dhe atë të Komisionit.

6. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë *, blerë në vitin 2006, me certifikatë pronësie datë 6.2.2007. Vlera 600.000 lekë me gjithë dokumentacionin e regjistrim. Burimi i krijimit: *puna ime dhe familja ndër vite*. Pjesa takuese: 100%.**

6.1 Referuar informacionit nga DPSHTRR-ja⁵⁸, rezultoi se shtetasi A. H. ka në pronësi automjetin me targë ***, të cilin e ka blerë në Gjermani me vlerën 1.500 euro (kursi i këmbimit 123 euro) sipas kontratës së shitblerjes datë 4.10.2006 dhe e ka zhdoganuar në datën 8.10.2006, duke paguar taksat në vlerën 257.093 lekë.

6.2 Rezultoi se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e administruar nga Komisioni.

6.3 Komisioni kreu analizën financiare të subjektit dhe familjes së bashkëjetuesit për vitin 2006, nga e cila rezultoi se ata kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti në vlerën 600.000 lekë.

7. Njësi shërbimi zyrë, me sip. 47,38 m², me adresë Fushë-Krujë, lagjja “**”, me kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.12.2011. Burimi i krijimit: *puna, aktiviteti privat e kursimet e mia*. Vlera 3.100.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.**

7.1 Referuar dokumentacionit^{59/60}, rezultoi se z. A. H. është pronar i pasurisë nr. ***, e llojit njësi shërbimi nr. ***, me sip. 47,38 m², kati 1, e ndodhur në z. k.***, lagjja “****”, Krujë, pasuri të cilën e ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. me çmimin 3.100.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes datë 19.12.2011.

Analiza e mundësisë financiare për blerjen e njësisë së shërbimit

7.2 Z. A. H. ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, si burim për krijimin e njësisë: “*Të ardhurat nga puna, aktiviteti privat e kursimet e tij*”. Gjithashtu, ka deklaruar: “*Të ardhura nga aktiviteti si avokat në periudhën tetor 2003 – mars 2009, si të ardhura me kuotë fikse nga tatimi mbi biznesin e vogël, me vlerë të deklaruar si qarkullim xhiro. Vlera rreth 5.000.000 lekë*”, si dhe “*Të ardhura nga aktiviteti si avokat shteti për periudhën mars 2009 – korrik 2011, paga bruto 68.089 lekë, e paga neto rreth 52.000 lekë/muaj. Vlera 1.456.000 lekë*”.

7.3 Nga verifikimi i të ardhurave të personit fizik “A. H.” nga profesioni avokat, për vitet 2005 (kur ka deklarime në Bashkinë Fushë-Krujë mbi qarkullimin e parashikuar ose të realizuar) deri në mars të vitit 2009 sipas deklaramit të tij, rezultoi se të ardhurat neto arrijnë në total vlerën 3.260.000 lekë⁶¹

7.4 Të ardhurat e dokumentuara nga puna e z. A. H. si avokat shteti për periudhën mars 2009 – korrik 2011, rezultuan në vlerën 1.498.912 lekë⁶².

⁵⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 31.5.2024, e DPSHTRR-së.

⁵⁹ Vërtetim hipotekor datë 31.1.2012 nga ZVRPP Krujë; kontratë shitblerjeje datë 19.12.2011; mandat bankar datë 12.12.2011 nga Alpha Bank.

⁶⁰ Shkresat nr. *** prot., datë 4.6.2024 dhe nr. *** prot., datë 26.7.2024, të ASHK Drejtoria Vendore Krujë; shkresa nr. ***, datë 4.6.2024, e FSHU-së, bashkëlidhur praktika e lidhjes së kontratës.

⁶¹ Të ardhurat e vitit 2009 janë përlogaritur në vlerën 1.200.000 lekë dhe duke supozuar që ato janë të krijuara në mënyrë të njëjtrajtshme për çdo muaj, pjesa që i takon periudhës Janar-Mars është 1.200.000:12 muaj x 3 muaj = 300.000 lekë.

⁶² Vërtetim dt.18.02.2010 nga Zyra Avokatisë së Shtetit administruar në dosjen e ILDKPKI dhe Shkresa *** prot. dt.30.05.2024 e Raiffeisen Bank e administruar në dosjen e Komisionit.

7.5 Kështu, të ardhurat totale nga puna e z. A. H., të cilat janë deklaruar si burim për të blerë njësinë në Fushë-Krujë, rezultuan në vlerën 4.758.912 lekë, të cilat e mbulojnë vlerën e pasurisë së blerë.

7.6 Sa i takon mundësisë financiare për të krijuar kursime nga burimet e deklaruara, Komisioni kreu analizën financiare, duke përdorur metodologjinë kumulative, nga ku rezultoi një balancë pozitive prej 1.124.943 lekësh⁶³.

7.7 Në konkluzion, duket se bashkëjetuesi i subjektit dhe familja e tij kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar kursimet nga puna e bashkëjetuesit (nga paga dhe aktiviteti i avokatit), por edhe nga të ardhura të tjera familjare, të krijuara deri në momentin e blerjes së njësisë.

7.8 Me marrjen në konsideratë të disa pretendimeve të subjektit, të trajtuara në çështjet 1.55-1.56 të vendimit, analiza financiare e mësipërme ndryshon. Nga analiza e rishikuar e Komisionit rezulton një balancë pozitive në vlerën 633.975 lekë, e cila nuk e ndryshon konkluzionin në lidhje me këtë pasuri.

7.9 Në përfundim, rezulton që bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit dhe familja e tij kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e njësisë në Fushë-Krujë në vlerën 3.100.000 lekë.

8. Llogari bankare në Raiffeisen Bank, sipas shkresës nxjerrje llogarie me datë 26.1.2017. Burimi i krijimit: të ardhura nga aktiviteti si noter. Vlera 2.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

8.1 Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të z. A. H. në këtë bankë, u evidentua se në datën 26.1.2017 është depozituar *cash* prej tij shuma 2.000.000 lekë.

Analiza e mundësisë financiare për krijimin e shumës 2.000.000 lekë

8.2 Në deklaratën *Vetting*, z. A. H. ka deklaruar si burim të shumës 2.000.000 lekë të ardhurat nga aktiviteti i tij si noter. Gjithashtu, në deklaratën *Vetting* ka deklaruar të ardhura në vlerën rreth 9.600.000 lekë për vitet 2011 – 2015 nga ky aktivitet.

8.3 Në lidhje me mundësinë e krijimit të të ardhurave nga aktiviteti si noter, Komisioni kreu hetimin dhe analizën, nga ku rezultoi:

8.4 Referuar informacionit nga DRT Durrës⁶⁴, personi fizik “A. H.” ka status aktiv që nga data 11.9.2006, me aktivitet juridik në Fushë-Krujë. Tatimpaguesi nuk ka dividend, pasi është biznes i vogël dhe detyrimet në kohë reale janë zero. Të ardhurat dhe fitimi (në lek) sipas viteve janë pasqyruar si në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 4

Viti	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Total
Të ardhurat	1,604,500	3,014,140	2,579,689	3,237,835	3,305,609	2,461,419	15,933,192
Fitimi para tatimit	1,249,166	2,246,659	1,918,199	2,729,361	2,540,809	2,026,469	12,710,633

8.5 Fitimit para tatimit të pasqyruar në tabelë i është zbritur tatimi dhe në këtë mënyrë është përfutur fitimi neto, i cili është përfshirë si e ardhur në analizën financiare të çdo viti përkatës. Të ardhurat e personit fizik “A. H.” janë trajtuar hollësisht në çështjet 1.31 - 1.37 të këtij vendimi.

⁶³ Të ardhura të dokumentuara të familjes 32.281.473 lekë, shpenzime 7.893.880 lekë, pasuri 23.262.650 lekë.

⁶⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 4.7.2017, të DRT Durrës, drejtuar ILDKPKI-së.

8.6 Mundësia financiare për krijimin e depozitës 2.000.000 lekë është pasqyruar në analizën financiare të subjektit gjatë detyrës, në çështjen 14 në vijim, e cila ka rezultuar me balancë pozitive.

9. Gjendje në bankë nga të ardhura nga aktiviteti si noter, sipas kontratës depozitë bankare në BKT datë 26.1.2017. Vlera 3.100.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

9.1 Referuar dokumentacionit që subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*⁶⁵, si dhe informacionit nga Banka Kombëtare Tregtare⁶⁶, rezultoi se z. A. H. në datën 26.1.2017 ka depozituar në këtë bankë shumën 3.100.000 lekë, të cilat janë investuar në depozitë me afat 1-vjeçar, me normë interesi 8%.

Analiza e mundësisë financiare për krijimin e depozitës 3.100.000 lekë

9.2 Meqenëse kjo depozitë është krijuar gjatë kohës së detyrës së subjektit të rivlerësimit nga bashkëjetuesi i saj si person i lidhur me të, Komisioni analizoi mundësisë financiare për krijimin e saj me burim “të ardhura nga aktiviteti si noter”.

9.3 Mundësia financiare për krijimin e kësaj depozite është trajtuar në çështjen 14 të këtij vendimi.

10. Gjendje cash nga të ardhurat nga aktiviteti si noter. Vlera 500.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

10.1 Meqenëse kjo depozitë është krijuar gjatë kohës së detyrës së subjektit të rivlerësimit nga bashkëjetuesi i saj si person i lidhur me të, Komisioni analizoi mundësisë financiare për krijimin e kësaj gjendjeje *cash* me burim të ardhura nga aktiviteti si noter.

10.2 Mundësia financiare për krijimin e vlerës *cash* prej 500.000 lekësh është trajtuar në çështjen 14 të këtij vendimi, e cila ka rezultuar me balancë pozitive.

Gjetje të tjera

11. Referuar informacioneve dhe dokumentacioneve⁶⁷ nga ASHK Drejtoria e Përgjithshme, ASHK Drejtoria Vendore Durrës, ASHK Drejtoria Vendore Krujë, dokumentacionit që subjekti ka depozituar gjatë hetimit administrativ⁶⁸, si dhe pamjeve me ortofoto të ASIG-ut⁶⁹, rezultoi se:

i) Shtetasi P. H. ka aplikuar me formular vetëdeklarimi nr. ***, datë 15.11.2006, për legalizimin e godinës 35 m² të ndërtuar në oborin e pasurisë nr. ***, në lagjen “****”, Fushë-Krujë, me sipërfaqe totale 170 m², sipërfaqe banimi 63 m², në pronësi të familjes H. dhe është pajisur me leje legalizimi nr. ***, datë 5.6.2013, të cilën e ka regjistruar në ZRPP, si dhe është pajisur me vërtetim pronësie datë 11.2.2016. Për këtë objekt, shtetasi P. H. ka kryer pagesat e procesit të legalizimit, në vlerë totale 17.400 lekë.

⁶⁵ Kontratë e depozitës bankare datë 26.1.2017, e lidhur midis z. A. H. dhe BKT-së, për hapjen e depozitës në shumën 3.100.000 lekë.

⁶⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2017, të BKT-së, drejtuar ILDKPKI-së (dosja *Vetting*, fq. 105).

⁶⁷ Shkresat nr. *** prot., datë 5.6.2024, e ASHK Drejtoria e Përgjithshme; nr. *** prot., datë 14.6.2024, e ASHK Drejtoria Vendore Durrës; nr. *** prot., datë 4.6.2024, e ASHK Drejtoria Vendore Krujë; shkresa nr. *** prot., datë 30.9.2024, e ASHK Drejtoria Qendrore,.

⁶⁸ Dërguar nga subjekti i rivlerësimit me pyetësin nr. 5, ndër të tjera, këto dokumente: (i) formular vetëdeklarimi datë 15.11.2006 për banesë (shtesë anësore), e përfunduar, në lagjen “****”, pallati ***, kati 1, me sipërfaqe sheshi 170 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 63 m²; (ii) leje legalizimi nr. ***, datë 5.6.2013, në emër të shtetasit P. H. për objektin “Godinë social ekonomike 1 kat” në lagjen “****”, Fushë-Krujë, z. k. ***, nr. pasurie ***, sipërfaqe parcele ndërtimore 35 m² dhe sipërfaqe ndërtimore 35 m²; (iii) vërtetim hipotekor datë 11.2.2016 për pronësinë e shtetasit P. H. mbi pasurinë nr. *** me sip. 35 m²; (iv) deklaratë për legalizim ndërtimi pa leje nr. ***, datë 30.1.2015, nga shtetasja S. H., që deklaroi ndërtim pa leje të ngritur në vitin 1990, në adresën SMT, Fushë-Krujë, bashkëlidhur certifikatat e pronësisë së pasurive nr. ***, në emër të familjes H. dhe nr. *** në emër të shtetasit A. H., si dhe certifikata familjare e familjes H.; (v) fotografi të shtesave.

⁶⁹ Sipas pamjeve ortofoto nga ASIG të viteve 1994, 2007 dhe 2015, rezultoi se objektet me sip. 35 m² dhe 10 m² shfaqen në ortofoton e vitit 1994 dhe deri në vitin 2015 brenda oborrit të pasurive nr. *** dhe nr. ***.

ii) Shtetasja S. M. H. ka aplikuar me formularin nr. ***, datë 31.1.2015, për legalizimin e objektit pa leje në Fushë-Krujë, ku ka deklaruar adresën e objektit, lagjja “****”, periudhën e ndërtimit 1990 dhe se trulli është me dokumente pronësie. Legalizimi i objektit me sip. 10 m² nuk ka përfunduar.

11.1 Rezultoi se të dy pasuritë e familjes H., nr. *** (vol. ***, fq. ***) dhe nr. *** (vol. ***, fq. ***), janë ngjitur me njëra-tjetrën si pjesë e një godine. Dy objektet që janë përfshirë në proces legalizimi ndodhen në oborrin e këtyre dy pasurive dhe janë në funksion të tyre.

11.2 Subjekti shpjegoi gjatë hetimit administrativ se nuk ka lidhje me asnjë nga këto pasuri në pronësi individuale apo familjare të familjes H. Pasuritë e përfshira në proces legalizimi ndodhen brenda oborrit të banesave të privatizuara në vitin 1993 dhe janë pjesë funksionale e tyre. Objekti me sip. 35 m² është ndërtuar para viteve ‘50-‘60, është rikonstruktuar nga fundi i viteve ‘80 nga ish-Komunale Banesa dhe në vitet 1995 – 1996 janë riparuar tarraca dhe dyshemeja. Objekti me sip. 10 m² është ndërtuar para vitit 1990 nga ish-Komunale Banesa. Të dyja objektet me sip. 35 m² dhe 10 m² nuk kanë qenë të përfshira në certifikatën e pronësisë së dy pasurive me nr. *** e nr. *** që në kohën e privatizimit, edhe pse kanë qenë pjesë funksionale e tyre, prandaj legalizimi u përdor si formë për të kryer regjistrimin e tyre në ZRPP.

11.3 Për sa më lart, Komisioni krijoi bindjen se dy objektet e përfshira në proces legalizimi janë krijuar përpara se subjekti të fillonte krijimin e të ardhurave dhe bashkëjetesën me bashkëjetuesin e saj dhe familjen e tij, prandaj objektet nuk lidhen me ndonjë investim apo kontribut personal të subjektit të rivlerësimit.

12. Nga informacioni i përcjellë nga BKT-ja u evidentua se babai i bashkëjetuesit, z. P. H., ka çelur një llogari kursimesh dyemërore, P. ose J. H..

12.1 Nga lëvizja e kësaj llogarie ka rezultuar se në datën 26.1.2017 babai i bashkëjetuesit ka derdhur në këtë llogari shumën 3.000.000 lekë, të cilën e ka investuar në depozitë me afat.

12.2 Subjekti shpjegoi⁷⁰ gjatë hetimit administrativ se babai i bashkëjetuesit të saj nuk ka pasur dhe nuk ka detyrim ligjor deklarimin e të ardhurave të tij të ligjshme, por ndoshta, nisur nga bisedat me djalin e tij (bashkëjetuesin e subjektit), i ka depozituar këto lekë në bankë sipas ligjit. Sidoqoftë, dokumentacioni në lidhje me të ardhurat e babait të bashkëjetuesit është paraqitur pranë Komisionit nga subjekti në pyetësorin nr. 3.

13. Duke qenë se depozitat e deklaruara dhe trajtuara në çështjet 8, 9, 10 dhe 12 të këtij vendimi janë të derdhura në bankë në datën 26.1.2017, pra pak ditë para plotësimit dhe dorëzimit të deklaratës *Vetting*, ato janë përfshirë në analizën financiare të subjektit, për periudhën gjatë detyrës.

14. Analiza financiare e subjektit të rivlerësimit gjatë detyrës dhe ndikimet në të të analizës para detyrës

14.1 Subjekti është analizuar për periudhën para detyrës e ndarë kjo në dy nënperiudha, para dhe pas bashkëjetesës, sikurse analizuar hollësisht në çështjen 1 të këtij vendimi. Gjatë periudhës para detyrës, Komisioni ka kryer edhe analiza të fragmentuara, të cilat i takojnë momenteve të krijimit të pasurive. Analizat i takojnë këtyre periudhave: (i) subjektit, kur ajo ka jetuar vetëm; (ii) subjektit së bashku me

⁷⁰ Përgjigjja nr. 3 e pyetësorit nr. 4.

familjen e bashkëjetuesit nga momenti i bashkëjetesës e deri në datën e emërimit në detyrë; (iii) familjes nga data e emërimit në detyrë e subjektit dhe deri në datën 31.1.2017.

14.2 Meqenëse subjekti i rivlerësimit është bërë subjekt deklarues në momentin e deklaratës *Vetting*, për shkak të ligjit, analiza financiare e çdo periudhe është kryer duke përdorur metodologjinë kumulative, e cila presupozon që mundësia për kursime pozitive e periudhës paraardhëse të mbartet në periudhën/at pasardhëse. Për këtë arsye, ndryshimi i çdo të dhëne financiare në secilën periudhë, afekton periudhat e tjera të analizuar në vijim dhe të gjithë analizën financiare në tërësi.

14.3 Në vlerësimin e tij përfundimtar, Komisioni mori në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të cilat u reflektuan në analizën financiare. Ndikimi i çdo elementi të ri, të përfshirë në analizën finale të subjektit gjatë detyrës, periudhë e cila nuk mund të shihet e ndarë nga ajo para detyrës, është si vijon:

14.3.1 Përfshirja e shumës 1.000.000 lekë si shpenzim për familjen e bashkëjetuesit para datës 1.4.2006, ka ndryshuar/zvogëluar mundësinë për kursime që familja i mbart në bashkëjetesë; ato bëhen në vlerën 9.206.728 lekë.

14.3.2 Përfshirja e shumës 252.684 lekë nga pagat e subjektit dhe e pjesës së mbetur të dhuratës prej 840.000 lekësh, si të ardhura në analizën e subjektit para bashkëjetesës, përmirëson mundësinë e saj për të krijuar depozitat bankare. Sidoqoftë, subjekti rezultoi me një pamundësi financiare, e cila zvogëlohet dhe bëhet në vlerën -767.869 lekë.

14.3.3 Nga përmirësimi i situatës së mësipërme të subjektit para bashkëjetesës, pasvjen edhe përmirësimi i situatës së mbartjes së likuiditeteve të saj në formën e depozitave bankare, në momentin kur pasuritë/likuiditetet e të dyja familjeve bashkohen në datën 1.4.2006.

14.3.4 Përfshirja e shumës 840.000 lekë, si shpenzim i familjes në vitin 2008, përtej atyre të jetesës, e zvogëlon mundësinë për kursime të familjes për vitet në vijim.

14.4 Sidoqoftë, me të gjitha ndryshimet e mësipërme, periudha pas bashkëjetesës, në çdo moment të analizimit të saj, ka mbetur me balanca pozitive, çka bën të mos ndryshojnë konkluzionet e arritura nga Komisioni në rezultatet e hetimit për çdo pasuri.

14.5 Sa i takon periudhës gjatë detyrës, subjekti është analizuar nga data 8.6.2016 dhe deri në datën e plotësimit dhe dorëzimit të deklaratës *Vetting*, 30.1.2017, së bashku me familjen e bashkëjetuesit.

14.6 Sipas analizës financiare të Komisionit, njoftuar subjektit me rezultatet e hetimit, kishte rezultuar se subjekti dhe familja e bashkëjetuesit të saj kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar pasuri/likuiditete dhe për të mbuluar të gjitha shpenzimet e tyre, për shkak të një balance pozitive prej 2.950.425 lekësh⁷¹.

⁷¹ Të ardhura në shumën 11.879.326 lekë, ku përfshihen: (i) të ardhurat nga puna e të gjithë anëtarëve të familjes për periudhën e analizuar; (ii) të ardhura nga periudha të mëparshme, në vlerën 9.823.741 lekë, e cila përfaqëson mundësinë për kursime të subjektit dhe familjes së bashkëjetuesit. Kjo e ardhur kumulative ka rezultuar si shumatore e të ardhurave të subjektit nga data 1.4.2006⁷¹ dhe e familjes së bashkëjetuesit nga viti 1997, pra ajo përfaqëson kursimet e krijuara përpara detyrës së subjektit dhe të sjella deri në datën e emërimit në detyrë të saj, 8.6.2016. Shpenzimet janë në vlerën 965.999 lekë dhe pasuria e përbërë nga shtesa e likuiditeteve është në vlerën 7.962.902 lekë, likuiditete të krijuara nga e gjithë familja, pas emërimit në detyrë të subjektit. Këtu përfshihen edhe depozitat në bankë në datën 26.1.2017 dhe kursimet *cash* të bashkëjetuesit dhe babait të tij, në total në shumën 8.600.000 lekë.

14.7 Pas rikryerjes së analizës financiare, subjekti dhe familja e bashkëjetuesit kanë rezultuar të kenë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar pasuritë në formën e likuiditeteve, depozita të reja në vlerën 8.600.000 lekë, në datën 26.1.2017, dhe për të mbuluar çdo shpenzim tjetër të evidentuar, sikurse është treguar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 5

Përshkrimi	<i>Nga data 8.6.2016 deri më 30.1.2017</i>
Pasuri	7,962,902
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	<i>7,962,902</i>
Të ardhura të dokumentuara	11,374,959
Të ardhura të subjektit nga paga si ndihmëse gjyqtare	419,122
Të ardhura të bashkëjetuesit si profesion i lirë (avokat dhe noter)	1,077,904
Të ardhura të babait të bashkëjetuesit	147,595
Të ardhura të nënës së bashkëjetuesit	135,331
Ta ardhura nga periudha të mëparshme	9,319,374 ⁷²
Shpenzime	965,999
Shpenzime jetese për 6 persona sipas standardit të ILDKPKI-së	941,849
Shpenzime udhëtimi nga banesa në punë	24,150
Mundësia për kursime kumulative	2,446,058

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka dërguar⁷³ pranë Komisionit raportin nr. ***, datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, të deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 21.10.2024, të KDZH-së, ku është konstatuar se: (a) subjekti i rivlerësimit ka pasur të njëjtat gjeneralitete si ato që ka deklaruar vetë në deklaratën për kontrollin e figurës; (b) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar, prandaj në përfundim u konstatua përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës.

2. Komisioni, nga ana e tij, nuk konstatoi gjatë hetimit elemente që mund të bien ndesh me përfundimet e AKSIK-së, prandaj konkludoi se subjekti i rivlerësimit arrin një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Grupi i Punës në KLGJ, në bazë të ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 96/2016, ka miratuar dhe përcjellë pranë Komisionit raportin⁷⁴ mbi aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Laureta Ahmeti, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

⁷² Ky është rezultati financiar/mundësia për kursime kumulative e familjes gjatë periudhës para emërimit në detyrë.

⁷³ Me shkresën nr. *** prot., datë 21.10.2024, të AKSIK-së.

⁷⁴ Raporti nr. *** prot., datë 27.1.2023, i KLGJ-së.

2. Ky raport, për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016⁷⁵, është hartuar në bazë të analizimit të tri grupeve të burimeve të informacionit: formularit të vetëvlerësimit; dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; 5 dosjet e vëzhguara të përzgjedhura me short⁷⁶. Në raport janë analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional, për të cilat Grupi i Punës ka konkluduar me një vlerësim pozitiv për subjektin e rivlerësimit.

3. Formulari i vetëdeklarimit, i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në KLD në datën 27.1.2017, paraqitet i nënshkruar prej saj dhe i plotë, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, duke bashkëlidhur dokumentacionin përkatës.

4. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGJ-ja dhe dokumentacionit bashkëlidhur, bazuar në nenet 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin E të Aneksit të Kushtetutës për rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me: formularin e vetëvlerësimit; 5 dosjet e përzgjedhura me short; aftësitë profesionale dhe organizative; etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale; aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

5. Në lidhje me tri dokumentet ligjore (projektvendime përfundimtare), të përzgjedhura për vlerësim nga subjekti i rivlerësimit⁷⁷ dhe që i janë bashkëlidhur formularit të vetëvlerësimit, Komisioni, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë ose përafërimit të këtyre 3 projektvendimeve të hartuara dhe të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, me vendimet përfundimtare të nënshkruara nga gjyqtarët përkatës, administroi⁷⁸ kopjet e vendimeve dhe bëri krahasimin midis tyre, ku përveç rezultateve pozitive të evidentuara nga KLGJ-ja, u konstatuan këto mangësi:

6. Projektvendimi për çështjen administrative nr. * regj., datë 26.5.2016**

- Projektvendimi është hartuar nga subjekti në 4 faqe, ndërsa vendimi përfundimtar i gjyqtarit në 9 faqe.
- Nga pikëpamja e formës, subjekti nuk ka përshkruar gjeneralitetet e palëve (atësi, datëlindje, vendlindje, vendbanim) dhe përfaqësuesve të tyre, por thjesht emrat e tyre.
- Nga pikëpamja e përmbajtjes, në pjesën hyrëse, subjekti hyn direkt në përshkrimin e rrethanave të çështjes dhe nuk përmend fillimisht rrethanat e fillimit të procesit gjyqësor, të cilat në vendimin përfundimtar janë përshkruar hollësisht (paraqitja e padisë nga paditësi para gjykatës; konstatimin

⁷⁵ Me urdhrin nr. ***, datë 13.6.2016, të kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, subjekti është emëruar ndihmëse ligjore pranë gjyqtarëve E. R. dhe E. R., ku për periudhën 13.6.2016 – 8.10.2016 i janë caktuar dhe ka përfunduar 298 çështje.

⁷⁶ (i) Çështja administrative nr. *** akti, regjistruar në datën 10.6.2016, me paditëse E. G., kundër të paditurit Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë, gjykuar me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 14.7.2016; (ii) çështja administrative nr. *** akti, regjistruar në datën 11.4.2016, me paditës H. B., kundër të paditurit Bashkia Dibër; (iii) çështja administrative nr. *** akti, regjistruar në datën 11.4.2016, me paditës H. B., kundër të paditurit Bashkia Dibër; (iv) çështja administrative nr. *** akti, regjistruar në datën 9.12.2015, me palë paditëse K. K., të paditur ***; shoqëria "*****" sh.p.k. dhe ndërmarrja "*****", gjykuar me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 29.7.2016; (v) çështja administrative nr. *** akti, regjistruar në datën 16.6.2016, me paditës R. P., kundër të paditurit Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, gjykuar me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 23.9.2016.

⁷⁷ Dokumenti 1. Projektvendimi për çështjen administrative nr. *** regj., datë 26.5.2016, me paditës shoqëria "*****" sh.p.k., të paditur ***; Dokumenti 2. Projektvendimi për çështjen administrative nr. *** regj., datë 15.6.2016, me paditës S. T., të paditur *** Tiranë; Dokumenti 3. Projektvendimi për çështjen administrative nr. *** regj., datë 27.10.2016, me paditës G. S., të paditur Ministria e ***, Njësia Operacionale Speciale, *** person i tretë ***.

⁷⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.2.2024, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përgjigje të shkresës nr. *** prot., datë 15.2.2024, të Komisionit.

juridiksionit dhe të kompetencës tokësore e lëndore, si dhe referimin e bazës ligjore në lidhje me këto veprime procedurale); nuk janë përshkruar dispozitat ligjore mbi të cilat gjykata administrative orientohet të gjykojë llojin e çështjes administrative objekt gjykimi (neni 3, pika 1 e ligjit nr. 49/2012).

- Në projektvendim mungojnë mjaft paragrafë dhe faqe të plota që gjenden në vendimin përfundimtar⁷⁹. Në projektvendim, subjekti ka cituar pjesën hyrëse, pasqyrimin e fakteve, duke cituar vetëm 5 prova shkresore, pretendimet e paditësit, prapësimet e të paditurit, vetëm një faqe arsyetim ligjor. Gjatë arsytimit, citohen si bazë ligjore e aktit administrativ të palës së paditur vetëm neni 15, pika 6 dhe neni 25, pika 1 e ligjit nr. 8540, datë 24.2.1999, që përcaktojnë përgjegjësinë e stacioneve të shitjes së karburanteve për cilësinë e karburanteve që shesin, detyrimin e tyre për të ruajtur kampionet e karburanteve që blejnë, si dhe e cilësojnë shkeljen e këtyre detyrimeve si kundërvajtje administrative.
- Nga ana tjetër, në vendim janë cituar si bazë ligjore edhe disa dispozita⁸⁰ të tjera të legjislacionit shqiptar, si dhe ka referuar edhe dispozita të legjislacionit ndërkombëtar.

7. Për sa më lart, duket se subjekti paraqet një projektvendim të cunguar në elementet e tij; një arsyetim shumë të shkurtër, jo i thelluar në ndërthurjen e rrethanave të çështjes me dispozitat ligjore përkatëse, si dhe i pambështetur në dispozita ligjore të mjaftueshme për të argumentuar plotësisht bazueshmërinë e aktit administrativ objekt gjykimi e, si rrjedhojë, edhe bazueshmërinë e vendimit gjyqësor që ka shqyrtuar këtë akt administrativ.

8. *Projektvendimi për çështjen administrative nr. *** regj., datë 15.6.2016.* Nga pikëpamja e formës, nuk përmban gjeneralitetet e palëve dhe përfaqësuesve të tyre (atësi, datëlindje, vendlindje, vendbanim), por thjesht emrat e tyre. Në përmbajtjen e projektvendimit nuk analizohet prova me dëshmitarë, e cila në vendim është cituar nga gjyqtari për të provuar punësimin e paditësit për periudhën e punësimit, që nuk njihet nga i padituri DRSSH Tiranë.

9. *Projektvendimi për çështjen administrative nr. *** regj., datë 27.10.2016.* Nga pikëpamja e formës, subjekti nuk ka përshkruar gjeneralitetet e paditësit (atësi, datëlindje, vendlindje, vendbanim), por thjesht emrat e tyre.

⁷⁹ Paragrafët ku citohen: veprimtaria e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), si dhe baza ligjore e kësaj veprimtarie, për të kuptuar nëse kjo palë është subjekt i ligjit nr. 49/2012; baza ligjore që kushtëzon disa veprime të ISHTI-së gjatë kontrollit të cilësisë së naftës dhe nënprodukteve të saj; faqet nr. 5-8 të vendimit në lidhje me arsyetimin e vendimit, ku pasqyrohen procedura e marrjes, administrimit, analizës së mostrës së naftës, që është marrë në depozitën e paditësit dhe baza ligjore që përcakton këto veprime, rrethanat e konfliktit objekt mosmarrëveshjeje, vlerësimi i gjykatës për rrethanat dhe faktet, referimi i bazës ligjore.

⁸⁰ Pika 6 e VKM-së nr. 147, datë 21.3.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë e diesel”; VKM nr. 781, datë 14.11.2012 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, për përdorim termik, civil, industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor”; VKM nr. 52, datë 14.1.2009 “Për cilësinë e lëndës djegëse gazoil prodhuar nga rafinimi i naftës bruto të nxjerrë në territorin e Shqipërisë dhe të tregtuar për automjetet rrugore e gjeneratorë”; standardi SSHEN ISO 3171:2002 “Metodat e punës për naftën dhe produktet e saj-lëngjet e naftës...”; standardi SSHEN ISO 3170:2004 “Metodat e provës për naftën dhe produktet e saj-lëngjet e naftës-marrja e mostrave me dorë”; direktiva 98 dhe direktiva 2003/17/EC e Parlamentit Europian (kushtuar cilësisë së karburanteve); neni 4 dhe kreu 2 i nenit 13 dhe neni 14 i ligjit nr. 10279/2010; pika 4, shkronjat “c” dhe “e” të VKM-së nr. 410, datë 13.5.2015; VKM nr. 410, datë 13.5.2015; neni 27, pika 1 e ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; urdhri nr. ***, datë 9.1.2015, i Ministrisë të Industrisë dhe Energjetikës; urdhri nr. ***, datë 9.12.2014, i ministrisë të Industrisë dhe Energjetikës.

10. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për të dhënë shpjegime dhe për të provuar të kundërtën e konkluzioneve si më lart për të tria projektvendimet.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

11. Në prapësimet ndaj barrës së provës, subjekti fillimisht shpjegoi se as Kodi i Procedurave Administrative e as ndonjë dispozitë tjetër ligjore nuk parashikon që në dosjen gjyqësore të përfshihen projektakte procedurale, të përgatitura dhe të nënshkruara nga ndihmësit ligjorë. Për këtë arsye, projektvendimet nuk gjendjen fizikisht në dosjen gjyqësore, por ia ka dërguar gjyqtarit përkatës me *email*, sikurse ka konfirmuar gjyqtari E. R. në informacionin e dërguar Komisionit gjatë hetimit.

12. Gjithashtu, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në periudhën objekt rivlerësimi profesional, nuk miratoi ndonjë rregullore për të normuar apo dokumentuar punën e ndihmësve ligjorë, sikurse konstatohet edhe në raportin e KLGJ-së.

13. Në kohën kur subjekti ka dorëzuar 3 projektvendimet përfundimtare në ish-KLD, nuk iu pranuan ato, as akte në formatin e vendimit gjyqësor, por iu kërkua të dorëzonte akte të nënshkruara si ndihmës ligjor, madje nga të gjithë ndihmësit ligjorë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë janë dorëzuar 3 akte procedurale me nënshkrimin e tyre. Ndërkohë, aktet procedurale që ka dërguar në ish-KLD për vlerësimin profesional, i janë dërguar gjyqtarëve E. R. dhe E. R. në formën e projektvendimeve përfundimtare, gjithmonë sipas udhëzimit të tyre dhe me *email*.

14. Në lidhje me projektvendimin e çështjes administrative nr. *** regj., datë 26.5.2016, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se nga përmbajtja e projektvendimit përfundimtar, dërguar gjyqtarit E. R. me *email*-in datë 28.9.2016, rezulton se: Nga pikëpamja e formës, janë përshkruar gjeneralitet e palëve dhe të përfaqësuesve të tyre (atësi, datëlindje, vendlindje, vendbanim). Nga pikëpamja e përmbajtjes, në pjesën hyrëse përshkruhen: paraqitja e padisë nga paditësi para gjykatës; konstatimi i juridiksionit dhe i kompetencës tokësore e lëndore; dispozitat ligjore mbi të cilat Gjykata Administrative orientohet të gjykojë llojin e çështjes administrative objekt gjykimi (ligji nr. 49/2012); pjesa hyrëse, pasqyrimi i fakteve, provat shkresore, pretendimet e paditësit, prapësimet e të paditurit, baza ligjore, neni 15, pika 6 dhe neni 25, pika 1 e ligjit nr. 8540, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”.

15. Sa më sipër, duke marrë në konsideratë periudhën 3-mujore si ndihmëse ligjore, subjekti mendon se me këtë projektvendim ka ndihmuar gjyqtarin në mënyre korrekte, duke parashtruar rrethanat, faktet sipas akteve në dosjen gjyqësore, pretendimet e paditësit dhe të paditurit, bazën ligjore, ka evidentuar kundërvajtjen administrative dhe ka analizuar dispozitat ligjore që janë shkelur nga paditësi në cilësinë e kundërvajtësit.

16. Bashkëlidhur, subjekti ka depozituar kopje të vendimit nr. ***, datë 20.9.2016, që i përket çështjes administrative nr. *** regj., datë 26.5.2016.

17. Në lidhje me projektvendimin e çështjes administrative nr. *** regj., datë 15.6.2016, subjekti shpjegoi se nga përmbajtja e këtij projektvendimi, dërguar gjyqtarit me *email*-in datë 18.11.2016, rezulton se: Projektvendimi dhe vendimi janë të njëjtë, me përjashtim të provës me dëshmitarë, e cila përshkruhet në procesverbalet e mbajtura gjatë gjykimit për evidentimin e seancave gjyqësore.

Mosevidentimi i kësaj prove mund të ketë ardhur nga mospasqyrimi i të gjitha procesverbaleve në dosje në momentin e zbardhjes së vendimit. (Ndodhte që edhe në rast të pakësimit apo shtimit të objektit të padisë, mungonte procesverbali. Subjekti i rivlerësimit i ka pasqyruar palët ndërgjyqëse si në momentin e paraqitjes së padisë dhe më pas ato janë ndryshuar nga vetë gjyqtari).

18. Bashkëlidhur, subjekti depozitoi kopje të vendimit nr. ***, datë 12.10.2016, që i përket çështjes administrative nr. *** regj., datë 15.6.2016.

19. Në lidhje me projektvendimin e çështjes administrative nr. *** regj., datë 27.10.2016, subjekti shpjegoi se projektvendimi që i ka dërguar gjyqtarit me *email*, nga pikëpamja e formës përmban gjeneralitetet e palëve dhe të përfaqësuesve të tyre, të njëjta me ato të përshkruara në vendim.

20. Bashkëlidhur, subjekti i rivlerësimit depozitoi kopje të vendimit nr. ***, datë 16.1.2017, që i përket çështjes administrative nr. *** regj., datë 27.10.2016.

Vlerësimi i Komisionit

21. Komisioni gjatë hetimit administrativ ka kryer vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke u nisur nga projektvendimet që janë administruar në dosjen e dërguar nga KLGJ-ja (projektvendime të dorëzuara nga subjekti në ish-KLD sipas procesverbalit nr. ***, datë 27.1.2017) dhe mbi bazën e të cilave është bërë vlerësimi i subjektit edhe nga ish-KLD.

22. Pavarësisht nga sa më lart, duke krahasuar edhe projektvendimet përfundimtare në formën e vendimeve gjyqësore, të cilat subjekti i paraqiti në prapësimet e saj, me vendimet gjyqësore përfundimtare që u administruan gjatë hetimit, Komisioni vëren se në 3 projektvendimet e paraqitura në prapësime janë paraqitur gjeneralitetet e palëve dhe të përfaqësuesve të tyre (atësi, datëlindje, vendlindje, vendbanim), por në projektvendimin e çështjes administrative nr. *** regj., datë 26.5.2016 dhe projektvendimin e çështjes administrative nr. *** regj., datë 15.6.2016, evidentohen sërish mangësitë e tjera të pasqyruara nga Komisioni në rezultatet e hetimit dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për këto mangësi nuk janë bindëse.

23. Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se projektvendimi i çështjes administrative nr. *** regj., datë 26.5.2016, i hartuar nga subjekti i rivlerësimit është një projektvendim me një arsyetim shumë të shkurtër, jo i thelluar në ndërthurjen e rrethanave të çështjes me dispozitat ligjore përkatëse, si dhe i pambështetur në dispozita ligjore të mjaftueshme për të argumentuar plotësisht bazueshmërinë e aktit administrativ objekt gjykimi e, si rrjedhojë, edhe bazueshmërinë e vendimit gjyqësor që ka shqyrtuar këtë akt administrativ. Ndërsa, në projektvendimin e çështjes administrative nr. *** regj., datë 15.6.2016, subjekti nuk ka pasqyruar dhe analizuar provën me dëshmitarë që citohet në vendim.

Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së dhe prokurorive (gjetje, ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime)

24. Nga verifikimi i të dhënave⁸¹ rezultoi se subjekti i rivlerësimit është emëruar ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me urdhrin nr. ***, datë 7.6.2016, të kryetarit të kësaj Gjykate dhe urdhrin nr. ***, datë 13.6.2016, të tij është caktuar ndihmës ligjor pranë gjyqtarëve E. R. dhe E. R..

⁸¹ Referuar shkresës nr. *** prot., datë 4.8.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, drejtuar KLGJ-së.

25. Në periudhën objekt i rivlerësimit kalimtar (8.10.2013 – 8.10.2016), subjekti ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nga data 13.6.2016 deri më 8.10.2016, për 4 muaj. Referuar parashikimit të nenit 41, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në rast se subjekti i rivlerësimit ka më pak se 3 vite në detyrë, periudha e vlerësimit konsiderohet e gjithë koha gjatë ushtrimit të detyrës.

26. Për subjektin e rivlerësimit nuk ka të dhëna në burimet arkivore të KLGJ-së për periudhën e rivlerësimit, për punën si ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

27. Prokuroritë e rretheve gjyqësore konfirmuan⁸² se ndaj subjektit të rivlerësimit nuk është regjistruar kallëzim penal, procedim penal i filluar, pushuar apo i mosfilluar; nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo të dhëna që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit.

28. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (PPKKO) konfirmoi⁸³ se në emër të subjektit të rivlerësimit nuk është regjistruar ndonjë procedim penal.

29. Bazuar në nenin 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, që parashikon se: “*Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe në b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës*”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka kryer një hetim në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke mbledhur informacion nga Shkolla e Magjistraturës dhe nga gjyqtari E. R., me të cilin ka punuar subjekti i rivlerësimit⁸⁴.

30. Sipas Shkollës së Magjistraturës⁸⁵, në testimin e aftësive profesionale të zhvilluar në datat 7-8 maj 2018 për subjektet *ex officio*, znj. Laureta Ahmeti (ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë) ka marrë gjithsej⁸⁶ 183 pikë.

31. Sipas gjyqtarit E. R.⁸⁷, gjatë periudhës që ai ka punuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë si gjyqtar dhe kryetar i saj, subjekti i rivlerësimit punonte si ndihmës ligjor i tij dhe përgatiste vetëm projektvendimet përfundimtare, të cilat ia dërgonte në adresën e *email*-it të tij privat. Bashkëlidhur, gjyqtari E. R. ka dërguar kopjen e projektvendimit të përgatitur nga subjekti i rivlerësimit për çështjen S. T. kundër ISSH-së, si dhe *email*-in datë 18.11.2016, me të cilin subjekti i ka dërguar këtë projektvendim.

⁸² Referuar informacionit me shkresën nr. *** prot., datë 20.6.2024, të Prokurorisë së Përgjithshme dhe me shkresa nga prokuroritë e rretheve gjyqësore: Tiranë nr. *** prot., datë 18.6.2024; Sarandë nr. *** prot., datë 10.6.2024; Shkodër nr. *** prot., datë 10.6.2024; Elbasan nr. *** prot., datë 10.6.2024; Fier nr. *** prot., datë 10.6.2024; Gjirokastrë nr. *** prot., datë 5.6.2024; Korçë nr. *** prot., datë 4.6.2024; Dibër nr. *** prot., datë 10.6.2024; Vlorë nr. *** prot., datë 5.6.2024; Durrës nr. *** prot., datë 13.6.2024; Kukës nr. *** prot., datë 5.6.2024; Berat nr. *** prot., datë 5.6.2024; Lezhë nr. *** prot., datë 10.6.2024.

⁸³ Shkresa nr. *** prot., datë 6.6.2024, e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, drejtuar Komisionit.

⁸⁴ Ndërsa gjyqtari E. R., me vendimin nr. *** prot., datë 29.7.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është shkarkuar nga detyra, prandaj Komisioni nuk mund t'i drejtohet këtij gjyqtari për të kërkuar informacion në lidhje me subjektin e rivlerësimit.

⁸⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 27.2.2024, e Shkollës së Magjistraturës, në përgjigje të shkresës nr. *** prot., datë 15.2.2024, të Komisionit.

⁸⁶ Në fazën e parë “Skantron” 54 pikë dhe në fazën e dytë “Testi profesional” 129 pikë. Bashkëlidhur janë vendimi nr. *** prot., datë 21.5.2018, i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, për miratimin e rezultateve të testit profesional të subjekteve *ex officio*, si dhe lista e subjekteve të testuara, ku evidentohet emri i znj. Laureta Ahmeti, me pikët përkatëse për çdo fazë testi.

⁸⁷ Shkresa datë 1.3.2024 e gjyqtarit E. R., dërguar në përgjigje të shkresës nr. *** prot., datë 15.2.2024, të Komisionit.

32. Në lidhje me performancën etiko-profesionale të subjektit të rivlerësimit, gjyqtari E. R. konfirmoi se ajo ka kryer me korrektësi dhe në kohë detyrën e ndihmësit ligjor dhe detyrat që ai i ka caktuar; ka respektuar normat e etikës në sjelljen me eprorët dhe kolegët, si dhe disiplinën në punë; nuk ka pasur asnjë sinjalizim për shkelje disiplinore të kryer nga subjekti i rivlerësimit.

33. Gjithashtu, Komisioni mori në shqyrtim edhe disa vendime gjyqësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të cilat subjekti i ka paraqitur gjatë hetimit administrativ⁸⁸, duke pretenduar se ka përgatitur projektin e këtyre vendimeve: vendimi nr. ***, datë 6.7.2016; vendimi nr. ***, datë 5.9.2016; vendimi nr. ***, datë 26.9.2016; vendimi nr. ***, datë 10.10.2016.

34. U konstatua mangësi vetëm në vendimin nr. ***, datë 26.9.2016, me paditës G. Z., të paditur Këshilli i Qarkut Dibër, me objekt “1) Deklarimin e pavlefshëm të zgjidhjes së kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme, të pajustificuar etj.”.

35. Gjykata ka vendosur: “1) Pranimin e pjesshëm të padisë; 2) Detyrimin e të paditurit të paguajë shpërblim në masën e 6 pagave mujore për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme e të pajustificuar etj.”.

36. Në këtë vendim, Komisioni konstatoi si mangësi: Subjekti i rivlerësimit nuk ka orientuar drejt gjyqtarin në lidhje me llojin e zgjidhjes së kontratës së punës, pasi e ka konsideruar si zgjidhje të menjëhershme pa shkaqe të justifikuara, ndërkohë që referuar provave dhe rrethanave që citohen në vendim, kemi të bëjmë më zgjidhje të justifikuar dhe jo të menjëhershme.

37. Në lidhje me shkakun e zgjidhjes së kontratës, i padituri Këshilli i Qarkut Dibër ka marrë vendimin nr. ***, datë 9.12.2015, për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me paditësin, në zbatim të VKM-së nr. 915, datë 11.11.2015 “Për transferimin në pronësi nga këshillat e qarqeve të bashkisë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së rrugëve”. Në pikën 6 të VKM-së nr. 915, datë 11.11.2015, përcaktohet: *“Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, ndërmarrjet e mirëmbajtjes së rrugëve rurale në varësi të këshillave të qarqeve, shkrihen. Kryetari i Qarkut, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi merr masa për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, për punonjësit e këtyre ndërmarrjeve duke respektuar afatet, procedurat dhe mënyrat e përcaktuara në Kodin e Punës”*.

38. Në lidhje me zgjidhjen e menjëhershme të kontratës, neni 143, pika 4 e Kodit të Punës përcakton: *“Kur njëra nga palët e zgjidh kontratën pa respektuar afatin e njoftimit, zgjidhja trajtohet si zgjidhje e kontratës me efekt të menjëhershëm”*. Pra, kontrata konsiderohet e zgjidhur “menjëherë” në rast se punëdhënësi nuk zbaton afatin e njoftimit sipas këtij neni, duke mos e paguar punëmarrësin me pagën e 1-3 muajve, në varësi të afatit që ka zgjatur marrëdhënia e punës. Ndërkohë, sipas provave të cituara në projektvendim, ka rezultuar se i padituri si punëdhënës i ka paguar paditësit si punëmarrës pagën e 3 muajve si afat njoftimi (madje edhe në arsyetimin e vendimit citohet se është paguar afati i njoftimit dhe gjykata ka rrëzuar kërkesën e paditësit për t’iu paguar paga e 3 muajve si afat njoftimi).

39. Për sa më lart, duket subjekti i rivlerësimit në projektvendimin e saj ka konkluduar gabim llojin e zgjidhjes së kontratës së punës si zgjidhje e menjëhershme pa shkak të justifikuar, duke orientuar kështu që paditësi të përfitonte në mënyrë të padrejtë 6 muaj pagë.

⁸⁸ Në pyetësin nr. 2.

40. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për të dhënë shpjegime dhe për të provuar të kundërtën e konkluzioneve si më lart.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

41. Në lidhje me çështjen gjyqësore, midis palëve ndërgjyqëse ka ekzistuar një marrëdhënie pune me afat të pacaktuar, që ka zgjatur nga data 26.11.2010 deri më 31.12.2015. Paditësi, në detyrën e *** të Drejtorisë **** Dibër, është liruar nga kjo detyrë me vendimin nr. ***, datë 9.12.2015 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, *** të Drejtorisë *** Dibër”, ku, ndër të tjera, përcaktohet: (1) Ndërprerja e marrëdhënieve të punës për z. G. Z., me detyrë *** i Drejtorisë *** Dibër; (2) Të dëmshpërblehet z. G. Z. për: lejen e pushimit vjetor të pakryer, gjithsej 21 ditë pune; afatet e njoftimit me pagën e 3 muajve; (3) Marrëdhëniet financiare të përfundojnë në datën 31.12.2015; (4) Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

42. Kjo marrëdhënie pune ka zgjatur më shumë se 5 vjet, prandaj afati i njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës është 3 muaj. Në rastin konkret, nuk është respektuar afati i njoftimit nga i padituri Këshilli i Qarkut Dibër, pasi akti i lirimit nga detyra mban datën 9.12.2015, ndërsa marrëdhëniet financiare me paditësin janë ndërprerë në datën 31.12.2015.

43. Në nenin 143 të Kodit Punës evidentohet qartë e drejta e punëmarrësit për të përfituar pagën gjatë periudhës së afatit të njoftimit. Pra, ligjvënësi ka konsideruar se afati i njoftimit respektohet vetëm nëse punëmarrësi vijon të ushtrojë detyrën e tij dhe kontrata e punës ende nuk është zgjidhur. Në rastin konkret, marrëdhëniet e punës nuk janë zgjidhur në përfundim të afatit 3-mujor të njoftimit, por pas 3 javësh, prandaj zgjidhja e kontratës së punës me afat të pacaktuar do të konsiderohet e menjëhershme. Pagimi i shpërblimit për mosrespektimin e afatit të njoftimit nga i padituri nuk provon respektimin e afatit të njoftimit nga ana e tij. I padituri e ka njohur dhe pranuar mosrespektimin e afatit të njoftimit dhe ka shpërblyer paditësin me 3 paga mujore, pasi ky ka ngritur padinë, prandaj kërkimi i paditësit për këtë dëmshpërblim është rrëzuar.

44. Në kuptim të nenit 153 të Kodit të Punës, kontrata mund të zgjidhet nga punëdhënësi pa respektuar afatin e njoftimit, vetëm nëse ka shkaqe të justifikuara, pra nëse punëmarrësi ka shkelur detyrimet kontraktuale me faj të rëndë apo me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, ndërkohë që në rastin konkret shkak i zgjidhjes së kontratës së punës është riorganizimi, transferimi i asetëve të Drejtorisë *** i Qarkut Dibër tek Bashkia Dibër. Pra, i padituri ka zgjidhur kontratën në mënyrë të pajustificuar. Zgjidhja pa shkak të arsyeshem i jep të drejtë paditësit G. Z., sipas nenit 155/3 të Kodit të Punës, të kërkojë dëmshpërblim me 12 paga mujore, por gjykata në analizë të rrethanave ka disponuar për 6 paga mujore. Në rastin konkret, rezultoi se nuk kemi zgjidhje të kontratës së punës në mënyrë të natyrshme nga punëdhënësi Këshilli i Qarkut Dibër, pasi nuk janë respektuar nenet 141, 143 e 144 të Kodit të Punës për zgjidhjen e kontratës së punës me afat të pacaktuar.

45. Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 26.9.2016, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për gjykimin e kësaj çështjeje, është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 1.2.2019.

Vlerësimi i Komisionit

46. Komisioni, pasi mori në konsideratë dhe vlerësoi shpjegimet dhe provat e vëna në dispozicion nga ana e subjektit të rivlerësimit, përfshirë këtu edhe vendimin nr. ***, datë 1.2.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 26.9.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, **i konsideron ato të mjaftueshme dhe bindëse, duke arritur në përfundimin se në projektvendimin nr. ***, datë 1.2.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të hartuar nga subjekti i rivlerësimit, nuk konstatohen mangësi.**

47. Ka rezultuar se për subjektin e rivlerësimit nuk është depozituar asnjë denoncim pranë Komisionit.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit profesional

48. Në përmbledhje të konkluzioneve, referuar raportit të hartuar nga Grupi i Punës në KLGJ dhe dokumentacionit bashkëlidhur, dokumentacionit të administruar nga Komisioni, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe me ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, trupi gjykues vlerëson se nuk janë konstatuar shkelje nga ana e subjektit të rivlerësimit, që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale dhe sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016 subjekti ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është efektive dhe efiçente në masë të pranueshme dhe përfundimisht u vlerësua për kriterin profesional “e aftë”.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, referuar neneve Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës, krerëve V, VI dhe VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore publike, në bindjen e brendshme të trupit gjykues, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Laureta Ahmeti:

- a. Lidhur me kriterin e pasurisë, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe për të krijuar pasurinë; ka bërë deklaram të saktë e të mjaftueshëm; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka zhvilluar procese në konflikt interesi, pra ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë. Këtë konkluzion përfundimtar në lidhje me kriterin e pasurisë nuk e afekton deri në një vlerësim negativ as balanca negative prej -767.869 lekësh, që i korrespondon periudhës qershor 2001 – 1.4.2006, para fillimit të detyrës dhe fillimit të bashkëjetesës, parë kjo edhe në dritën e parimit të proporcionalitetit.
- b. Lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 34 të ligjit nr. 84/2016, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit është “e aftë”, duke arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të pikës 1/a të nenit 58, si dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Laureta Ahmeti, ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, aktualisht ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 4.11.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj